



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 shtator 2013
Nr. ref.:AGJ 471/13

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KO108/13

Parashtrues

Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-209, për Amnisti

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit

1. Parashtrues të kërkesës janë: Albulena Haxhiu, Visar Ymeri, Albin Kurti, Glauk Konjufca, Rexhep Selimi, Afrim Kasolli, Afrim Hoti, Liburn Aliu, Albana Gashi, Emin Gërbeshi, Albana Fetoshi, Agim Kuleta dhe Aurora Bakalli, që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kanë autorizuar znj. Albulena Haxhiu që t'i përfaqësojë ata në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Ligjin, Nr. 04/L-209, për Amnisti cili është miratuar nga Kuvendi më 11 korrik 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit kërkojnë shqyrtimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Amnisti, Nr. 04/L-209, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), me Vendimin nr. 04-V-646, të 11 korrikut 2013.

Baza juridike

4. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 42 dhe neni 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 36 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 korrik 2013, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Gjykatë.
6. Më 19 korrik 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KO108/13, caktoi Gjyqtaren Snezhana Botusharova për Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KO108/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtarë).
7. Më 22 korrik 2013, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për kërkesën dhe kërkoi nga ata të dorëzojnë komentet e tyre, si dhe çfarëdo dokumentesh që ata i konsiderojnë të domosdoshme për sa i përket kërkesës.
8. Më 22 korrik 2013, Presidentja e Republikës së Kosovës u informua për kërkesën e dorëzuar nga parashtruesit në Gjykatë.
9. Më 25 korrik 2013, Presidentja e Republikës së Kosovës kërkoi nga Gjykata sqarime përkitazi me kërkesën për Ligjin për Amnisti, si dhe për detyrimet e saj kushtetuese, pra nëse ajo mund të shpallë Ligjin për Amnisti, si dhe nëse do të ishte e nevojshme të vendosej një masë e përkohshme.
10. Të njëjtën ditë, Gjykata iu përgjigj Presidentes së Republikës së Kosovës, si në vijim:

“[...]

Ju njoftojmë se Ligji për Amnisti nuk ka hyrë dhe nuk mund të hyjë në fuqi, përderisa Gjykata Kushtetuese të japë vendimin e saj përfundimtar.

Ju bëjmë me dije faktin se çdo përpjekje për ta publikuar Ligjin për Amnisti dhe, për pasojë, fillimin e zbatimit të tij në praktikë, paraqet një akt jokushtetues, të pavlefshëm dhe joekzistent.

Ligji për Amnisti nuk ka hyrë në fuqi dhe nuk mund të hyjë në fuqi derisa Gjykata nuk ka dhënë vendimin e vet dhe, për pasojë, ligji në fjalë nuk mund të prodhojë asnjë efekt legal.

[...]"

11. Më 29 korrik 2013, Gjykata mori këto dokumente, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës:
 - a. Raportin final të Komisionit funksional për Legjislacion, të 11 korrikut 2013, përkitazi me Ligjin për Amnisti;
 - b. Transkriptin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 11 korrik 2013;
 - c. Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 11 korrik 2013;
 - d. Listën e votimit elektronik;
 - e. Vendimin e Kuvendit, të 11 korrikut 2013, për miratimin e Ligjit, Nr. 04/L-209, për Amnisti (Vendimi nr. 04-V-646); dhe
 - f. Ligjin për Amnisti, Nr. 04/L-209.
12. Më 1 gusht 2013, parashtruesit dorëzuan informata shtesë, duke sqaruar disa pika të kërkesës së tyre.
13. Më 13 gusht 2013, Gjykata e informoi Kuvendin dhe Qeverinë për dorëzimin e informacioneve shtesë nga parashtruesit dhe u kërkoi atyre të paraqesin komentet e tyre.
14. Më 19 gusht 2013, Qeveria i ofroi Gjykatës komentet e saj përkitazi me informacionet shtesë të parashtrueseve, të dorëzuara më 1 gusht 2013.
15. Më 20 gusht 2013, Qeveria dorëzoi në Gjykatë *“Komente lidhur me kërkesën e znj. Albulena Haxhiu dhe 12 anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, KO108/13, e datës 19 korrik 2013”*.
16. Më 21 gusht 2013, parashtruesit u informuan për komentet e Qeverisë.
17. Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtarja raportuese Snezhana Botusharova dhe i paraqiti rekomandimin Gjykatës në përbërje të plotë.
18. Më 3 shtator 2013, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.

Përmbledhje e fakteve

19. Më 25 qershor 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi të miratojë Projektligjin për Amnisti dhe udhëzoi Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që t'ia paraqesë Projektligjin Kuvendit të Kosovës, për shqyrtim dhe për miratim.
20. Sipas Memorandumit shpjegues të Projektligjit "*[Ky] ligj rregullon kushtet dhe procedurën me të cilën jepet amnisti për personat të cilët janë dënuar për një veprë penale, personat të cilët janë nën ndjekje penale për vepra penale, apo personat të cilët mund të jenë objekt i ndjekjes penale për veprat penale të kryera para 20 qershorit 2013 brenda territorit që tani përbën Republikën e Kosovës*".
21. Më 11 korrik 2013, në pajtim me nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 58 e me nenin 84 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 04-V-646, miratoi Ligjin për Amnisti, Nr. 04/L-209, me 90 vota për, me 17 vota kundër dhe me një abstenim dhe ia dërgoi atë Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje.
22. Më 19 korrik 2013, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 42 e me nenin 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, parashtruesit dorëzuan kërkesë në këtë gjykatë për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Amnisti, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 11 korrik 2013, duke kontestuar përmbajtjen e tij dhe procedurën për miratimin e tij.

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit

Aspekti përmbajtjesor i kërkesës

23. Parashtruesit konsiderojnë se qëllimi i Ligjit për Amnisti është amnistia e personave nga ndjekja penale dhe amnistia e personave që nuk e kanë kryer dënimin e tyre para 20 qershorit 2013. Sipas tyre, Ligji: "*[...] përfshin amnistinë e personave që kanë kryer gjithsej 67 (gjashtëdhjeteshtatë) vepra penale nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25, datë 6 korrik 2003, dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligjit Penal të KSAK G. Zyrtare nr. 20/77 lidhur me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59 për ligjin në fuqi në Kosovë dhe të gjitha veprat penale të parapara me Kodin Penal të RSFJ-së*". Sipas pikëpamjes së parashtruesve, Ligji për Amnisti nuk ka paraparë një datë të fillimit, por vetëm ka paraparë datën e limitimit kohor të amnistimit të veprave të kryera para asaj date.
24. Parashtruesit theksojnë se, në doktrinën juridiko-penale, arsyeja kryesore e sanksionimit të veprave penale është fokusi në mbrojtjen e integritetit shoqëror dhe personal nga veprimet e dëmshme që mund t'i cenojnë vlerat e caktuara, dhe pikërisht këtu edhe qëndron baza kryesore e parimit të ligjshmërisë në dëgjën penale të çdo sistemi juridik.

25. Duke marrë parasysh se Ligji për Amnisti përmban dispozita me të cilat personat që kanë kryer vepra penale që i kanë shkaktuar pasoja palës së dëmtuar, në procedurat penale janë të liruar nga ndjekja penale dhe nga vuajtja e plotë e dënimit, parashtruesit konstatojnë se amnistia e personave të tillë shkel të drejtën e palës së dëmtuar për të shfrytëzuar mjetet efektive juridike që lidhen me ushtrimin e të drejtës së tyre për ndjekje penale dhe të kompensimit individual.
26. Sipas pikëpamjes së parashtruesve, krahas veprës penale kundër shtetit apo kundër rendit kushtetues dhe veprave që ndërlidhen me shkeljen e obligimeve fiskale dhe doganore, neni 3 [Kushtet për dhënien e amnistisë nga ndjekja penale dhe vuajtja e plotë e dënimit] i Ligjit përfshin veprat penale nga të cilat kanë mundur të shkaktohen, ose me të cilat është tentuar të shkaktohen, pasoja të dëmshme për cilindo qytetar të Republikës së Kosovës apo për shtetas të huaj.
27. Më pas, parashtruesit numërojnë veprat penale sipas nenit 3.1 të Ligjit, të cilat kanë dëmtuar ose që mund të kenë dëmtuar interesat e individëve:

“[...]”

1.1 Veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 19/13 2012), dhe atë:

- 1.1.10 Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë (neni 333, paragrafi 1);*
- 1.1.11 Zjarrvënia (neni 334, paragrafi 1);*
- 1.1.12 Mbajtja në pronësi, kontrolli ose posedimi i paautorizuar i armëve (neni 374);*
- 1.1.13 Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të veprave (neni 386, vetëm ndërlidhur me moslajmërimin e veprave penale për të cilat jepet amnisti me këtë nen);*
- 1.1.14 Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 388, vetëm ndërlidhur me dhënien e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale për të cilat jepet amnisti me këtë nen);*
- 1.1.15.1 Kanosja e kandidatit (neni 211);*
- 1.1.15.2 Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar (neni 212);*
- 1.1.15.3 Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (neni 290, nënparagrafët: 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të paragrafit 1);*
- 1.1.15.9 Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo me mjete të rrezikshme (neni 380, paragrafët: 1, 2 dhe 5);*

- 1.1.15.10 *Falsifikimi i dokumenteve (neni 398);*
- 1.1.15.11 *Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve (neni 399, nënparagrafët: 1.1 dhe 1.4, të paragrafit 1);*
- 1.1.15.12 *Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 409, paragrafët: 1, 2 dhe 3);*
- 1.1.15.13 *Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (neni 410, paragrafi 1), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje; dhe*
- 1.1.16 *Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm (neni 412), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje.*

1.2 Veprat penale sipas Kodit Penal të Kosovës (Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, datë 6 korrik 2003, Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 2003/25) dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës:

- 1.2.5 *Dëmtimi i pasurisë së luajtshme (neni 260);*
- 1.2.7 *Moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryesit të tyre (neni 303, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);*
- 1.2.8 *Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale (neni 305, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);*
- 1.2.9.6 *Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo me mjete të rrezikshme (neni 299, paragrafët: 1 dhe 2);*
- 1.2.9.7 *Falsifikimi i dokumenteve zyrtare (neni 348);*
- 1.2.9.8 *Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 316);*
- 1.2.9.9 *Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (neni 317), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje;*
- 1.2.10 *Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale (neni 320), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje.*

1.3 Veprat penale të Ligjit Penal të KSAK, G. Zyrtare nr. 20/77, lidhur me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59 për ligjin në fuqi në Kosovë, në vijim:

- 1.3.1 *Dëmtimi i sendit të huaj (neni 145);*
- 1.3.3 *Moslajmërimi i veprës penale dhe kryesit (neni 173, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);*
- 1.3.4 *Ndihma kryesit pas kryerjes së veprës penale (neni 174, vetëm ndërlidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me këtë ligj);*
- 1.3.5.5 *Rrezikimi i trafikut publik me veprime ose me mjete të rrezikshme (neni 167);*
- 1.3.5.6 *Falsifikimi i dokumentit (neni 203);*
- 1.3.5.7 *Falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 184);*
- 1.3.5.8 *Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare (neni 183);*
- 1.3.5.9 *Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (neni 184, paragrafët: 1, 2 dhe 4), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje;*
- 1.3.6 *Pjesëmarrja në grup që kryen vepra penale (neni 200, përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje).*

[...]"

28. Parashtruesit më tej theksojnë se çështja kryesore e kërkesës është shkelja e të drejtës subjektive për mjet juridik të palës së dëmtuar për të iniciuar procedura penale kundër kryesit të veprës penale ose veprës penale në tentativë, për të cilën është dhënë amnistia sipas nenit 3 të Ligjit për Amnisti. Sipas pikëpamjes së tyre, rrjedhimisht, cenohet e drejta për të shfrytëzuar mjetet juridike, siç garantohet me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
29. Për më tepër, sipas të drejtës penale, pala e dëmtuar ka të drejtë të dorëzojë kërkesë për ndjekje, derisa sipas legjislacionit të mëparshëm – Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale – ka ekzistuar institucioni i paditësit privat dhe i paditësit subsidiar në procedurat penale. Bazuar në këtë, parashtruesit pohojnë se neni 6, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Penale, Nr. 04/L-123, përcakton të drejtën e palës së dëmtuar për të parashtruar kërkesë te Prokurori i Shtetit për të iniciuar procedurë penale. Neni 79, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Penale, megjithatë, ia kufizon Prokurorit të drejtën për të vepruar ashtu, varësisht prej kërkesës për ndjekje nga pala e dëmtuar.
30. Parashtruesit pohojnë se kërkesa për ndjekje penale është një mjet i rëndësishëm juridik, qëllimi i së cilës është t'i mundësojë palës së dëmtuar të

mbrojë interesat e veta individuale nga aspekti penal si dhe nga aspekti civil, kur bëhet fjalë për kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me dëme materiale apo me dëme morale të shkaktuara nga vepra penale. Sipas pikëpamjes së parashtruesve, e drejta për kërkesë për ndjekje është pa dyshim e mbrojtur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë], paragrafi 1 dhe paragrafi 2, të Kushtetutës, ku paragrafi 1 i garanton secilit “*mbrojtje të barabartë të të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike*”.

31. Dhënia e amnistisë personave që kanë kryer, ose që dyshohet se kanë kryer, një nga veprat penale të specifikuara në këtë kërkesë, ia bën të pamundur palës së dëmtuar të shfrytëzojë mjetet juridike nëpërmjet të të cilave ai/ajo mund të mbrojë interesat e veta juridike sa i përket dëmit të mundshëm të shkaktuar nga vepra penale. Parashtruesit, pra, pohojnë se garantimi i mbrojtjes së barabartë të të drejtave, siç parashihet me nenin 31.1. të Kushtetutës, është i pamundur, pasi shkelet e drejta e palës së dëmtuar për të shfrytëzuar mjetin juridik.
32. Ata më tej i referohen nenit 31.2 të Kushtetutës, që thotë: “*Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj*”. Sipas mendimit të tyre, neni 3 i Ligjit për Amnisti bën të pamundur garantimin kushtetues të së drejtës për proces gjyqësor nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. Prandaj, duke i dhënë amnisti personave të dyshuar ose të dënuar për vepra penale, që përmenden në nenin 3 të Ligjit dhe të specifikuara në këtë kërkesë, shkelet neni 31.2, pasi bëhet i pamundur zhvillimi i procedurës penale kundër personave të tillë.
33. Sa i përket nenit 32 të Kushtetutës, që parasheh: “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*”, parashtruesit pohojnë që neni 8.1 i Ligjit për Amnisti përcakton se, në çdo rast ku janë ngritur kallëzimet penale, është iniciuar një hetim, ose është ngritur një aktakuzë, prokurori kompetent do të ndërpresë të gjitha këto procedura në përputhshmëri me këtë ligj, me ç’rast u jep amnisti personave në fjalë.
34. Sipas mendimit të tyre, duke ia njohur këtë autorizim prokurorit [për të vepruar ashtu], shkelet e drejta e palës së dëmtuar për shfrytëzimin e mjeteve juridike kundër vendimit për ndërprerjen e procedurave penale, në kundërshtim me nenin 31.1 dhe me nenin 32 të Kushtetutës, të cilat nene njohin të drejtën e pacenueshme të palëve për të përdorur mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore që shkelin të drejtat dhe interesat e tyre, në mënyrën e paraparë me ligj.
35. Parashtruesit më tej pohojnë se, përpos nenit 31 dhe nenit 32 të Kushtetutës, miratimi i Ligjit do të sjell gjithashtu edhe shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1 dhe paragrafi 2, të Kushtetutës. Pengesa, që pala e dëmtuar të ushtrojë të drejtën për të mbrojtur interesin e vet juridik, si dhe për të parashtruar kërkesë për ndjekje penale, duke përfshirë kërkesat pronësore, përbën pabarazi për të gjitha palët e dëmtuara që kanë pësuar dëme nga kryerja e veprave penale të përcaktuara me nenin 3 të Ligjit për Amnisti.

36. Parashtruesit konsiderojnë se përfshirja e veprave penale në nenin 3 të Ligjit shkel dispozitat e nenit 13 dhe të nenit 14, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe, në veçanti, citohet neni 13: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*. Sipas pikëpamjes së tyre, çdo e drejtë e garantuar me Konventë, duke përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 6, nënkupton të drejtën për mjet efektiv para një autoriteti shtetëror.
37. Ata pohojnë se, përveç nenit 6 të KEDNJ-së, gjithashtu është shkelur neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së, kur merret parasysh se dëmtimi i pronës dhe e drejta absolute e titullarit për të mbrojtur pronën me mjete ligjore është në rrezik. Në anën tjetër, ata konsiderojnë se neni 6. 1 i KEDNJ-së i garanton çdokujt të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme që do të vendosë për natyrën e çështjes, qoftë ajo e natyrës penale apo civile. Sipas pikëpamjes së tyre, neni 3 dhe neni 8.1 e 8.2 të Ligjit për Amnisti kanë shkelur të drejtat e palëve që kanë qenë të dëmtuara nga veprat penale të përfshira në nenin 3 të Ligjit, duke ua mohuar të drejtën që çështja e tyre të shqyrtohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
38. Parashtruesit më tej pretendojnë shkeljen e nenit 14 të KEDNJ-së, i cili thotë: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*. Sipas mendimit të tyre, realizimi i të drejtave të parapara sipas kësaj konvente, e cila përfshin nenin 6 dhe nenin 13, duhet të sigurohet pa ndonjë dallim mbi bazë të statusit shoqëror.
39. Ata, gjithashtu, konsiderojnë se shkelja e të drejtës së palës së dëmtuar në një gjykatë, ku do të shqyrtohej rasti i saj, përbën një rrethanë diskriminuese në raport me palët e tjera të dëmtuara, që kanë qenë të dëmtuara nga vepra e tjera penale që nuk janë përfshirë në nenin 3 të Ligjit.
40. Parashtruesit më tej i referohen disa aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që kanë të bëjnë me kuptimin e nenit 13 të KEDNJ-së. Në rastin Iatridis kundër Greqisë, disa parime themelore, sa i përket kësaj të drejte, janë përfshirë si në vijim: *“Gjykata vëren se kërkesa lidhur me nenin 13 ka rrjedhë dhe themelësi të ngjashme juridike me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së përkitazi me pacenueshmërinë dhe pashtershmërinë e mjeteve juridike. Vetëm se ekziston një dallim për nga natyra e nenit 13 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së; i pari (neni 13) jep garanci procedurale që përfshin por nuk kufizohet vetëm tek mjete juridik, ndërsa në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së është përfshirë detyrimi gjithëpërfshirës për sa i përket lirisë dhe së drejtës së pronësisë”*.
41. Parashtruesit më tej i referohen rastit Buyukday kundër Turqisë, ku GJEDNJ konstatoi: *“Kërkesa, të cilën e përmban neni 13, duhet të jetë e jetësueshme dhe*

e zbatueshme si në praktikë ashtu edhe në sanksionim ligjor, sidomos kur gëzimi i së drejtës varet nga veprimet apo nga mosveprimet e organeve shtetërore të shtetit përgjegjës”.

42. Përfundimisht, parashtruesit përmendin rastin Leander kundër Suedisë, ku GJEDNJ-ja njëjloj ka përcaktuar disa parime për interpretimin e të drejtës së përkufizuar në nenin 13 të KEDNJ-së dhe theksohet në veçanti parimi: *“Secilit person, i cili tregon se i është cenuar ndonjë e drejtë nga kjo konventë, duhet t’i njihet e drejta në mjet efektiv juridik për t’i mbrojtur të drejtat e tij subjektive që burojnë nga kjo konventë”.*
43. Ata konsiderojnë se, këtu, GJEDNJ-ja shkon më tej sa i përket njohjes së të drejtës për mjet efektiv juridik, kur thekson se autoritetet shtetërore, të përmendura në nenin 13 të Konventës, nuk është e thënë të jenë organet e drejtësisë, por përkufizimi i këtyre organeve ka karakter të gjerë institucional.
44. Përfundimisht, parashtruesit pretendojnë se dispozitat e mësipërme të nenit 3 të Ligjit për Amnisti shkelin nenin 3.1 dhe 3.2, nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe nenet: 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
45. Në sqarimet e tyre shtesë, të dorëzuara më 1 gusht 2013, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pohojnë:

“...

Në dispozitën e nenit 5 të Ligjit për Amnisti, është theksuar se: ‘Me dhënien e amnistisë nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në dënimin apo aktgjykimin’.

Me këtë dispozitë është siguruar mundësia që personat e tretë të realizojnë të drejtat në procedura të tjera që do të mund të ndërliqej ekzistimi i një raporti të detyrimit, apo ndonjë raport tjetër juridik, i cili varet nga vendimi gjyqësor i nxjerrë në procedurën penale si, për shembull, kërkesa pasurore juridike.

Por, për këtë, duhet të kemi parasysh se kjo dispozitë ka të bëjë me kategorinë e personave ndaj të cilëve është zhvilluar procedura dhe për çështjen penale është vendosur me vendim merititor. Pra, duke pasur parasysh se, me dispozitat e nenit 3 të Ligjit për Amnisti, personat që kanë kryer veprat penale të përcaktuara me këtë nen, amnistohen nga ndjekja penale dhe nga vuajtja e plotë e dënimit, me ç’rast dispozita e nenit 5 të Ligjit për Amnisti do të mund të zbatohet vetëm për kategorinë e personave që lirohen nga vuajtja e plotë e dënimit. Kjo sepse të drejtat e personave të tretë varen nga vendimi i nxjerrë gjyqësor.

Të kundërtën, personat të cilët kanë interesin juridik për ta realizuar atë në procesin gjyqësor, nuk e kanë të mundur të realizojnë atë ndaj personave të cilët lirohen nga ndjekja penale, ngase, nga vetë fakti se ata lirohen nga ndjekja penale, procedura ndaj personave të kësaj kategorie (qoftë në fazën e nismës me kallëzim penal, apo në atë të procedurës parapenale-hetimore,

ose në fazën pas ngritjes së aktakuzës), pushon në tërësi, siç është theksuar në nenin 8, par. 1 dhe 2, të Ligjit për Amnisti.

Me këtë rast, duhet të vëmë në theks se Ligji për Procedurën Kontestimore, në nenin 14, thekson: 'Në procedurën kontestimore, gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor'.

Me këtë dispozitë është e qartë se, pala e tretë, për ta realizuar, për shembull, kërkesën pasurore-juridike në procedurën kontestimore, kërkesën e tillë do t'ia parashtojë gjykatës kompetente, e cila në procedurë kontestimore është e lidhur me aktgjykimin me të cilin konstatohet dhe vërtetohet fajësia, që është bazë juridike për evidencimin e shkaktimit të dëmit, qoftë material apo moral.

Pra, gjykata, në procedurë kontestimore sipas kërkesës pasurore-juridike, do të vlerësojë vetëm lartësinë e dëmit të shkaktuar nga kryerja e veprës penale dhe e njëjta nuk do të vërtetojë fajësinë e kryesit, ngase këtë do ta vërtetojë gjykata në procedurë penale. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, është e qartë se gjykata, në procedurë kontestimore, është e varur në vendosje nga shpallja e personit në cilësinë e të pandehurit, si fajtor. Pra, gjykata, në çdo rast do të vendosë vetëm pasi i pandehuri të shpallet fajtor sipas aktgjykimit të gjykatës, e cila ka vendosur në procedurë penale.

...

Sa i përket aspektit procedural të kërkesës

46. Parashtruesit pohojnë se, edhe pse Projektligji i parë për Amnisti nuk ishte votuar në seancën e 4 korrikut 2013, Qeveria e Kosovës ka tërhequr tekstin dhe, ditën e nesërme, ia ka prezantuar Kuvendit një Projektligj të reviduar. Ky tekst i reviduar është shqyrtuar nga Komisioni Legjislativ, më 8 korrik 2013. Pra, përsëri, është shkëlur neni 65.4 i Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, në të cilin kërkohet që, së paku katër ditë pune para mbledhjes së thirrur, të sigurohet i gjithë materiali për shqyrtim. Sipas pikëpamjes së parashtruesve, duke pasur parasysh se projektligjet janë objekt kryesor i shqyrtimit në mbledhjet e Kuvendit, është e pakuptimtë dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 65.4 të Rregullores të thirret mbledhja pa u përmbushur kushtet e përcaktuara me këtë dispozitë, dhe që rendi i ditës të futet në kundërshtim me afatet kohore të parapara me këtë dispozitë.
47. Parashtruesit më tej theksojnë se, në seancën plenare të 11 korrikut 2013, që do të thotë se pa kaluar ende periudha minimale prej dy javësh pune, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e 8 korrikut 2013, vendosi të procedojë këtë projektligj, duke mos marrë parasysh shqyrtimin e bërë nga Komisioni raportues. Më 11 korrik 2013, Kuvendi, duke votuar për kërkesën e grupit parlamentar të PDK-së për shmangie nga procedurat, ka proceduar Projektligjin për Amnisti në dy lexime brenda të njëjtës seancë: leximi i parë – paradite, dhe i dyti – pasdite. Pas votimit në lexim të parë, Kuvendi ka ngarkuar Komisionin për Legjislacion që të shqyrtojë Projektligjin për lexim të dytë.

48. Sa i përket kësaj, parashtruesit i referohen nenit 57.3 të Rregullores së punës, ku thuhet: *“Amendamente në projektligj mund të parashtrorë deputeti, grupi parlamentar, komisioni parlamentar dhe Qeveria, në afat prej dy javësh pune nga miratimi në parim. Amendamentet i adresohen komisionit funksional-raportues”*. Sipas pikëpamjes së parashtruesve, është shkelur e drejta e deputetëve për të dërguar amendamente në afatin kohor të paraparë me Rregullore.
49. Ata, më tutje, theksojnë se nuk do të duhej të bëhej shmangie nga veprimet cilësore, por do të duhej gjithherë të kuptohej si shmangie nga procedurat formale që nuk kanë ndikim në cilësinë e vendimit për të cilin zhvillohet procedura e tillë. Sipas pikëpamjes së tyre, duke mos e paraqitur Projektligjin në këto komisione të përhershme, është shkelur neni 57.3 i Rregullores së punës të Kuvendit.
50. Parashtruesit përfundimisht theksojnë se Komisioni për Legjislacion, gjatë shqyrtimit të këtij ligji, veçanërisht gjatë shqyrtimit të Projektligjit, në asnjë moment nuk e ka shqyrtuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e Projektligjit, tashmë ligj i ratifikuar. Në këtë drejtim, ata i referohen pikës 3, të Shtojcës 2, të Rregullores së punës të Kuvendit, e cila saktëson fushëveprimin e komisioneve parlamentare që, konkretisht, analizojnë dhe vlerësojnë përshtatshmërinë e akteve, të cilat i miraton Kuvendi i Kosovës, me Kushtetutën dhe që shqyrtojnë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e projektligjeve.
51. Ata përfundojnë se, po ashtu, siç mund të shihet qartë edhe në transkriptin e Komisionit për Legjislacion, këto përgjegjësi nuk janë përmbushur në procedurën e shqyrtimit para leximit të parë të Projektligjit për Amnisti. Prandaj, Projektligji për Amnisti është proceduar në kundërshtim me nenin 65.4 të Rregullores së punës të Kuvendit. Për më tepër, për shkak të shkeljes së të drejtës për dërgimin e amendamenteve brenda afatit kohor të paraparë me Rregullore, Projektligji për Amnisti është proceduar në kundërshtim me nenin 57.3 të Rregullores së punës të Kuvendit.

Argumentet e paraqitura nga Qeveria

52. Sa i përket informacioneve shtesë, të dorëzuara nga parashtruesit në Gjykatë, më 1 gusht 2013, sipas Qeverisë, Gjykata duhet *“të shpallë të papranueshëm kundërshtimin shtesë, të paraqitur nga një anëtar i vetëm i Parlamentit të Kosovës, më 13 gusht 2013, për shkak të mungesës së bazës ligjore apo procedurale”*.
53. Qeveria konsideron se ekziston *“[...] e drejta e palëve në procedurë, sipas nenit 22.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, për të siguruar fakte shtesë për Gjykatën, por që i nënshtrohet tri kushteve kumulative dhe të domosdoshme: së pari, që referimi të jetë i paqartë ose i paplotë; së dyti, që vetë gjykata, nëpërmjet Gjyqtarit raportues, kërkon informacion të tillë nga pala; dhe, së treti, që informacioni i kërkuar do të jetë vetëm në natyrën e ‘fakteve të tjera që janë të nevojshme për të vlerësuar pranueshmërinë ose baza për padi”*. Sa i përket kësaj, Qeveria pohon se paraqitja e parashtruesve nuk mbulohet me këtë dispozitë, por duhet të konsiderohet si *“[...] një kundërshtim i ri/shtesë, i*

paraqitur nga ajo personalisht”, [...] për shkak se “[...] kërkesa origjinale nuk flet fare për kushtetutshmërinë e nenit 5 të Ligjit për Amnisti”.

54. Përveç kësaj, këndvështrimi i Qeverisë është se “[...] letra e znj. Haxhiu është thjeshtë një shkresë e saj personale dhe, si e tillë, nuk mund të konsiderohet si pjesë e kërkesës së nënshkruar nga 13 anëtarë të Parlamentit. Nëse anëtarët e Parlamentit kishin pasur për qëllim që me sukses të kundërshtonin edhe nenin 5 të Ligjit për Amnisti, ashtu siç kanë kundërshtuar nenin 3 të Ligjit për Amnisti, atëherë kjo do të ishte pjesë e kërkesës së tyre origjinale”.
55. Më 20 gusht 2013, Qeveria i ofroi Gjykatës komentet përkitazi me Rastin Nr. KO108/13, duke pretenduar se:
- a. *“Ligji i Kosovës për Amnisti është në përputhje të plotë me ligjin ndërkombëtar dhe me Kushtetutën e Kosovës;*
 - b. *Ligji për Amnisti nuk shkel të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë;*
 - c. *Çdo kufizim i pretenduar i të drejtave në Kapitullin II të Kushtetutës është në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës;*
 - d. *Procedura për miratimin e Ligjit për Amnisti ishte në pajtueshmëri me Rregulloren e brendshme të Kuvendit të Kosovës”.*
56. Qeveria thekson se *“amnistitë janë një instrument ligjor i pranuar dhe i njohur në të drejtën ndërkombëtare [...]”, i cili “[...] ka qenë përdorur në vende të tjera dhe është vlerësuar nga gjykatat ndërkombëtare”. Në këtë drejtim, “Qeveria e Kosovës ka qenë dhe ende është në një situatë jo të ndryshme nga vendet e tjera në transicion. Pas një lufte guerile dhe të ashpër, vendi ka pësuar një ndarje de facto të një pjese të territorit të saj, e cila ka mbajtur marrëdhëniet e saj tmerrësisht armiqësore me shtetin fqinj. Përpjekja e fundit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është iniciuar nga vetë Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). Më 8 shtator të vitit 2010, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë, të ashtuquajtur ‘Mirëpritja e gatishmërisë së Bashkimit Evropian për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet palëve; ku procesi i dialogut në vetvete do të jetë një faktor për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon, dhe se dialogu do të promovojë bashkëpunim, të arrijë përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe do të përmirësojë jetën e njerëzve’ [UNGA, Rezoluta A/64/L.65/Rev. 1; fq. 2]. Në këtë mënyrë, edhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e sheh procesin e dialogut si të domosdoshëm për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon. Ligji për Amnisti është pa dyshim një pjesë integrale e atij procesi”.*
57. Për më tepër, Qeveria konsideron se *“[...] Ligji për Amnisti i Kosovës është një amnisti e hartuar me kujdes, e cila nuk bën në asnjë mënyrë të përfshijë krime të rënda, të dhunshme, kundër ligjit dhe praktikës ndërkombëtare”.*
58. Sipas Qeverisë, *“përveç të drejtës ndërkombëtare të përmendur më lart, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), trajton përputhshmërinë e ligjeve për amnisti. GJEDNJ, praktika gjyqësore e së cilës është e detyrueshme për këtë Gjykatë të Nderuar, deri më tani nuk ka vlerësuar që ndonjë nga ligjet për amnisti të jetë në kundërshtim me KEDNJ-në. Megjithatë, GJEDNJ-ja ka gjykuar shumë raste në të cilat ligjet për*

amnisti janë konsideruar si ligjore dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare [Shih, Dujardin kundër Francës, Tarbuk kundër Kroacisë, Margus kundër Kroacisë].

59. Sa i përket asaj nëse Ligji për Amnisti pakëson të drejtat dhe liritë sipas Kapitullit II të Kushtetutës, Qeveria thekson se *“pala parashtruese, në mënyrë eksplicite ka theksuar dhe ka bazuar gjithë argumentin e kërkesës mbi pretendimin e tyre se vetë ekzistenca e amnistisë zvogëlon të drejtat sipas Kapitullit II të Kushtetutës sonë. Në paragrafin e dytë, pala parashtruese pretendon se ‘duke pasur parasysh se Ligji për Amnisti [...] përmban dispozita me të cilat lirohen nga ndjekja penale dhe vuajtja e plotë e dënimit edhe personat të cilët kanë kryer vepra penale nga të cilat shkaktohet pasoja e dëmtimit të personave që në aspektin procedural mund të paraqiten në procedurë penale si palë të dëmtuara, konsiderohet se lirimi i personave nga ndjekja penale dhe nga vuajtja e dënimit cenon të drejtën e disponueshme për të shfrytëzuar mjetet e efektshme juridike lidhur me realizimin e së drejtës për ndjekje penale dhe realizimit të kërkesës subjektive në cilësinë e palës së dëmtuar’. Prandaj, bazuar në këtë, është më se e qartë se argumenti i palës parashtruese kërkon strehim dhe bazë ligjore mbi diçka që Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për të kundërtën. Kjo gjykatë ka vendosur që amnistia, si një institut, duke përfshirë atë që do të duhej, është me të vërtetë në përputhje të plotë me Kushtetutën tonë”.*
60. Sa i përket asaj nëse neni 3 i Ligjit për Amnisti shkel ndonjë të drejtë sipas Kapitullit II të Kushtetutës dhe sipas nenit 6 e nenit 13 të KEDNJ-së, Qeveria shpreh pikëpamjen se *“Ligji është hartuar me kujdes jo vetëm për të shmangur dhënien e amnistisë për krimet e rënda apo për shkeljet e të drejtave të njeriut, por për të minimizuar paaftësinë e çdo viktime për të mbuluar dëmet. Kjo është treguar nga Ligji për Amnisti, në përjashtimet e amnistisë në nenin 4 dhe në dispozitën përjashtuese të nenit 5. Për shembull, në bazë të nenit 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, kushdo që i shkakton dëm tjetrit është përgjegjës. Nuk kërkohet një hetim penal për t’i paraprirë çështjes civile”.*
61. Sa i përket asaj nëse neni 3 i Ligjit për Amnisti shkel nenin 14 dhe Protokollin 12 të KEDNJ-së, Qeveria vëren: *“Amnistia nuk është e bazuar mbi ndonjë kategori të tillë, si: gjinia, përkatësia etnike, apo kategori tjetër të mbrojtur me Kushtetutë. Nëse ligji do të rezultojë me amnistimin e ndonjë përqindje më të madhe të një gjinie apo grupi etnik, do të jetë thjesht për shkak se këto grupe kanë marrë pjesë në ato vepra penale ose kanë pasur këto motive në një normë më të lartë. Këto grupe të njerëzve, për nga natyra e tyre, nuk do të ishin në ‘situata analoge’ ose në ‘situata relativisht të ngjashme’ me ato që nuk kanë kryer këto vepra penale ose që kanë pasur këto motive. Edhe nëse kjo gjykatë do të vendoste se grupe personash që përfitojnë nga amnistia dhe ata që nuk përfitojnë nga ajo janë në një situatë analoge, atëherë ekziston një ‘justifikim i arsyeshëm dhe objektiv’ për këtë dallim në trajtim, sepse dhënia e kësaj amnistie ka qenë pjesë e negociatave ndërkombëtare për tërheqjen e institucioneve të Serbisë nga Republika e Kosovës”.*
62. Sa i përket asaj nëse neni 5 i Ligjit për Amnisti shkel të drejtat e viktimave në bazë të Kushtetutës, Qeveria thekson se *“gjuha e nenit 5 është një shpjegim i thjeshtë për interpretim nga gjykatat në të ardhmen. Për shembull, kur një*

gjykatë aplikon amnistinë me një vendim për dhënien amnisti sipas nenit 8 të Ligjit, ajo duhet të ketë të qartë se vendimet e nxjerra paraprakisht mbi bazën e atij vendimi penal nuk duhet të shpallen të pavlefshme, ndonëse personi lirohet nga ndjekja apo nga vuajtja e dënimit për po të njëjtën vepër penale. Megjithatë, kjo në asnjë mënyrë nuk i ndal viktimat e tjera në të ardhmen për të ndjekur të drejtat e tyre në procedurë civile, kur kryesit e veprave penale nuk janë dënuar”. [...] “Kjo ndodh për shkak se Ligji mbi Procedurën Kontestimore është ende i vlefshëm dhe ai u ofron të gjitha palëve të drejtë të paraqesin padi për dëmet në çdo kohë”.

63. Sa i përket asaj nëse ndonjë kufizim i pretenduar i të drejtave sipas Kushtetutës është në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës, Qeveria thekson se *“[...] Ligji për Amnisti nuk ka ndërmend të anashkalojnë thelbin e të drejtave të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, apo kushtet e nenit 55, dhe se ekziston një lidhje e qartë dhe themelore ndërmjet qëllimit të çfarëdo kufizimi të mundshëm, në njërin anë, dhe qëllimit për të cilin ai përdoret”.*
64. Sa i përket procedurës për miratimin e Ligjit, Qeveria thekson se miratimi i Ligjit është bërë në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit.
65. Sa i përket asaj nëse është shkelur neni 65.4 i Rregullores së punës të Kuvendit, Qeveria konsideron se *“neni 65, paragrafi 4, i Rregullores, i cili thotë: ‘Komisioni mund të ftojë në mbledhje përfaqësues të institucioneve dhe të shoqërisë civile’ dhe, prandaj, [...] nuk ka asnjë lidhshmëri të këtij neni me kërkesën e paraqitur nga deputetët e Kuvendit”.*
66. Sa i përket asaj nëse është shkelur neni 64.4 i Rregullores së punës të Kuvendit, Qeveria konsideron se *“me propozim të njërit prej deputetëve – anëtar i Komisionit – dhe me mbështetje të shumicës së deputetëve (me vetëm një votë kundër), Komisioni ka vendosur për ndryshimin e rendit të ditës dhe për futjen në shqyrtim si pikë e parë e rendit të ditës, shqyrtimin në parim të Projektligjit për Amnisti. Pas shqyrtimit, Komisioni, me shumicë votash, i ka rekomanduar Kuvendit të miratojë Projektligjin për Amnisti”. Rrjedhimisht, Qeveria pretendon se kontestimi përkitazi me periudhën katërditore është i pabazuar.*
67. Sa i përket procedurës së votimit, Qeveria konsideron se *“propozimi i njërit nga deputetët e Kuvendit për shmangie nga Rregullorja, përkatësisht për futje si pikë të parë të rendit të ditës ‘shqyrtimin në lexim të parë të Projektligjit për Amnisti’, është mbështetur nga gjithsej 84 deputetë, 14 kundër dhe asnjë abstenim. Në lexim të parë, Projektligji për Amnisti është miratuar nga Kuvendi me 91 vota për, 17 ishin kundër dhe nuk pati asnjë abstenim. I gjithë ky procedim është në përputhje të plotë me Rregulloren dhe me nenin 65, paragrafi 1, pika 15, të Kushtetutës. Më pas, me propozim të të njëjtit deputet, në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, më 11.7.2013, në sesionin e pasdites, është futur si pikë e parë e rendit të ditës shqyrtimi në lexim të dytë i Projektligjit për Amnisti. Shqyrtimi në lexim të dytë, përkatësisht futja si pikë e parë e rendit të ditës, është bërë po ashtu në pajtim me nenin 84 të Rregullores dhe i njëjti është mbështetur me votat e 86 deputetëve, 14 ishin kundër dhe nuk pati asnjë abstenim. Kuvendi ka miratuar Projektligjin për Amnisti me 90 vota për, 17 ishin kundër dhe pati një abstenim, në përputhje të plotë me Rregulloren dhe me nenin 65, paragrafi 1, pika 15, të Kushtetutës”.*

Pranueshmëria e kërkesës

68. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
69. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
70. Përkitazi me këto kërkesa, Gjykata vëren se parashtruesit kanë parashtruar kërkesën e tyre në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, i cili parasheh:
- “Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”*. [Versioni serbisht ndryshon nga versionet anglisht dhe shqip].
71. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, kur një ligj ose një akt është në shqyrtim sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, procedura e vlerësimit do të jetë e natyrës pezulluese, ashtu që do të bllokohet shpallja e ligjit derisa Gjykata të marrë një vendim përfundimtar për rastin. Në pajtim me nenin 43 (2) të Ligjit, në rast se një ligj i miratuar nga Kuvendi kontestohet sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, *“ligji [...] i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*, që do të thotë se Ligji i miratuar nuk duhet t'i kthehet Kuvendit, por duhet t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje, pa nenet të cilat Gjykata i ka shpallur në Aktgjykimin e saj si të papajtueshme me Kushtetutën.
72. Kjo është vërtetuar në mënyrë analoge nga Gjykata në Aktgjykimin e saj në rastet KO29/12 dhe KO48/12, kur vendosi: *“Është me rëndësi të theksohet që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Ky është një juridiksion ex-post i Gjykatës, si garantuese e Kushtetutës, për ta siguruar përputhjen e legjislacionit me aktin më të lartë të shtetit, pra me Kushtetutën. Përveç këtij juridiksioni, Gjykata gjithashtu ka juridiksionin e ashtuquajtur ex-ante për vlerësim paraprak të kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar. Ky juridiksion i jepet Gjykatës, si mbrojtëse e Kushtetutës, për të siguruar që amendamenti i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar në Kapitullin II të Kushtetutës”* (Shih, Rasti KO29/12 dhe Rasti KO48/12, parashtrues Kryetari i Kuvendit, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012).
73. Rastet e cituara më sipër kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës për të shqyrtuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të amendamenteve kushtetuese të propozuara në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, ku shqyrtimi është i kufizuar në pajtueshmërinë me dispozitat e Kapitullit II të Kushtetutës. Në rastin konkret, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, juridiksioni i Gjykatës përfshin

shqyrtimin e përputhshmërisë së ligjit të kontestuar me të gjitha dispozitat e Kushtetutës.

74. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është parashtruar nga 13 deputetë të Kuvendit të Kosovës.
75. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 42 të Ligjit që rregullon parashtrimin e kërkesës sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, si në vijim:

Neni 42 – Saktësimi i kërkesës

1. *Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme: [Versioni shqip dhe serbisht dallon nga versioni anglisht]*
- 1.1. *Emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit, që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo të vendimit të nxjerrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;*
- 1.2. *Dispozitat e Kushtetutës, apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. *Paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.*
76. Përveç emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve që kanë parashtruar kërkesën, janë përmendur ligji i kontestuar dhe dispozitat përkatëse të Kushtetutës, si dhe provat mbështetëse të kërkesës.
77. Sa i përket ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se parashtruesit kontestojnë Ligjin për Amnisti, Nr. 04/L-209.
78. Gjykata, prandaj, konsideron se janë përmbushur kërkesat e nenit 42 të Ligjit.
79. Sa i përket afatit kohor, Gjykata vëren se Ligji për Amnisti, Nr. 04/L-209, është miratuar nga Kuvendi më 11 korrik 2013 (Vendimi nr. 04-V-646) dhe kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 19 korrik 2013. Në pajtim me rregullin 27(1) (Llogaritja e periudhës kohore) të Rregullores së punës: *“Periudha kohore e përcaktuar me Kushtetutë, me ligj dhe me këtë rregullore të punës llogaritet si më poshtë: (1) Kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet nga dita në të cilën ndodh një ngjarje, atëherë dita kur ndodh ajo ngjarje ose veprim nuk llogaritet se bën pjesë në atë periudhë”.* Prandaj, kërkesa është dorëzuar brenda periudhës kohore prej tetë ditësh, e paraparë me Kushtetutë.
80. Sa i përket informacioneve shtesë, të dorëzuara nga parashtruesit më 1 gusht 2013, Gjykata konsideron se është e pranueshme letra e parashtruesve në emër të përfaqësueses së tyre, znj. Albulena Haxhiu. Ajo përmban sqarime të mëtejshme nga parashtruesit për një çështje që ata kanë ngritur tashmë në kërkesën e tyre. Së fundmi, Gjykata është ajo që vendos për provat e paraqitura se si të procedohet me to.

81. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka baza që kërkesën, e cila ngre çështje të rëndësishme kushtetuese, ta shpallë të papranueshme.

Analiza krahasimtare e situatës

Konteksti socio-politik

82. Në mënyrë që të kemi një kuptim të qartë të qëllimit dhe të fushëveprimit të Ligjit për Amnisti, Gjykata i referohet nenit 1 [Qëllimi dhe fushëveprimi] të Kapitullit I, Dispozitat e Përgjithshme të Ligjit, që parasheh:

“Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurën me të cilën jepet amnisti për personat të cilët janë dënuar për një veprë penale, personat të cilët janë nën ndjekje penale për vepra penale, apo personat të cilët mund të jenë objekt i ndjekjes penale për veprat penale të kryera para 20 qershorit 2013 brenda territorit që tani përbën Republikën e Kosovës”.

83. Edhe pse neni, në mënyrë përmbledhëse, përcakton fushëveprimin e Ligjit, neni qëndron i heshtur për sa i përket qëllimit. Megjithatë, Memorandumi shpjegues për Projektligjin për Amnisti, kur është paraqitur nga Qeveria në Kuvend për miratim, në nenin 2 të tij [Objektivat dhe ndërlidhja e tyre me prioritetet e Qeverisë], qëllimin e Ligjit e përshkruan me këto fjalë:

“Me qëllim të krijimit të një infrastrukture ligjore, e cila synon krijimin e një ambienti të qëndrueshëm dhe në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit, si dhe të udhëhequr nga parimet e humanizmit, rrezikshmërisë së ulët të personave të cilët amnistohen si dhe mbrojtjen e interesat publike, miratimi i këtij projektligji do të ketë si efekt pozitiv realizimin e qëllimit të dënimit, po ashtu do të ndikojë pozitivisht edhe në risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar për kategoritë e caktuara të veprave penale”.

84. Gjykata e kupton se, në mënyrë që të konsolidohet rendi juridik i Kosovës dhe që të sigurohet shtrirja e autoritetit shtetëror në të gjitha pjesët e Republikës, është e nevojshme të inkorporohen në territorin e Kosovës komunitetet që kanë vepruar brenda kornizave institucionale të Republikës së Serbisë. Amnistia mund të shihet si kontribut në këtë konsolidim, duke mos penalizuar personat që kanë vepruar brenda kornizave të tjera institucionale deri më tani. Si e tillë, ajo ka për qëllim të qartë të lehtësojë transicionin e këtyre komuniteteve në kuadër të administratës publike dhe të institucioneve të sigurisë të Kosovës.

85. Gjykata vëren se Ligji për Amnisti nuk përcakton kategoritë e personave dhe sjelljet të cilat sjellin amnisti, por e kufizon veten duke ofruar një katalog të veprave penale për të cilat do të jepet amnistia. Për më tepër, periudha kohore gjatë së cilës do të jepet amnistia është definuar ashtu që fillon përafërsisht me fundin e luftës në vitin 1999 dhe vazhdon deri më 20 qershor vitin 2013. Çështja e datës së fillimit të zbatimit të amnistisë është diskutuar më poshtë në nenin 2 të Ligjit. Gjatë kësaj periudhe disi të gjatë kohore, territori i Kosovës ka qenë nën juridiksionin ligjor të një sërë autoritetesh, më shumë ose më pak të ndryshme, deri në pavarësimin e Republikës të Kosovës. Gjykata vëren se ligjshmëria e këtyre autoriteteve të njëpasnjëshme nuk është duke u kontestuar,

dhe Ligji për Amnisti merr parasysh këto autoritete të njëpasnjëshme me përkufizimet e veta nga një sërë kodesh dhe ligjesh penale.

86. Gjykata është e vetëdijshme për faktin e njohur dhe publik se ky ligj ka ngritur shqetësime të shoqëria civile dhe ndër sektorë të caktuar të komuniteteve profesionale dhe të biznesit. Këto shqetësime kanë të bëjnë, *inter alia*, me përmasat e konsiderueshme të shkatërrimit të pronës private, që ka prekur të gjitha komunitetet që nga lufta, dhe për të cilat, relativisht, një numër i vogël i ndjekjeve penale ka përfunduar me sukses. Përveç kësaj, ekziston një perceptim mbizotërues se një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të biznesit të paligjshëm është zhvilluar gjatë periudhës kohore që nga lufta, me pasoja të dëmshme për buxhetin e shtetit dhe për konkurrencën e biznesit të ligjshëm, por edhe kanë pasur ndikim negativ ndaj shëndetit publik dhe mirëqenies. Ka disa shqetësime se Ligji për Amnisti legjitimon një shkallë të mosndëshkimit për praktika të tilla të paligjshme, pa marrë parasysh se kush i ka shkaktuar ato.
87. Deri në masën që amnistia ka për qëllim t'i kontribuojë pajtimit ndërmjet komuniteteve të Kosovës, një amnisti e gjerë për shkatërrimin dhe për djegien e pronave private, në fakt, mund të minojë këtë objektiv. Deri në masën që amnistia është menduar për të konsoliduar sundimin e ligjit dhe për të shtrirë administrimin e autoritetit publik, duke garantuar mosndëshkim për aktivitete të caktuara kriminale, një amnisti e gjerë për aktivitete të paligjshme profesionale dhe të biznesit praktikisht mund të shërbejë për të minuar rendin juridik të Kosovës. Gjykata konsideron se Ligji për Amnisti, ashtu siç është shkruar, potencialisht mund të ketë ndikim negativ në legjitimitetin e rendit publik në tërë Kosovën. Kjo mund të dëmtojë objektivin "*për të krijuar një infrastrukturë ligjore, e cila synon të krijojë një mjedis të qëndrueshëm dhe në funksion të sundimit të rendit dhe të ligjit*", siç përcaktohet në Memorandumin shpjegues.
88. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, rrjedhimisht, Gjykata do të marrë parasysh objektivat e përcaktuara në Memorandumin e mësipërm shpjegues, si dhe kontekstin e sotëm social dhe politik të Kosovës.

Parimi i amnistisë

89. Sa i përket parimit të amnistisë, Gjykata i referohet nenit 65 të Kushtetutës, i cili, në paragrafin 15, përcakton kompetencat e Kuvendit të Kosovës: "*Jep amnisti me ligj përkatës, i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit*".
90. Sipas mendimit të Gjykatës, pasi as dispozitat kushtetuese e as ndonjë dispozitë tjetër e Ligjit nuk përmban një udhëzim të mëtutjeshëm për Gjykatën sa i përket konceptit të amnistisë të paraparë me nenin 65.15 të Kushtetutës, Gjykata do t'i referohet legjislacionit përkatës në vendet fqinje dhe standardeve të pranuaruara ndërkombëtarisht në këtë fushë.
91. Sa i përket kësaj, Gjykata konstaton se amnistia mund të përkufizohet si përfundim i kryesve të shkeljeve të ligjit nga të qenit i ndjekur penalisht.

92. Megjithatë, ligjet për amnisti duhet të dallohen nga format e tjera të mosdëshkimit, për shkak të kontekstit politik në të cilin janë aprovuar, Motivet për nxjerrjen e një ligji për amnisti janë të ndryshme, por në përgjithësi ligjet për amnisti nxirren për shembull gjatë konfliktit për t'i dhënë fund dhunës, si pjesë e një marrëveshje paqësore, në mënyrë që të promovohet pajtimi mes palëve të përfshira, etj. Amnistia mbulon përveç individëve që janë dënuar dhe që janë duke vuajtur dënimin e tyre, edhe individët që janë duke u hetuar apo që do të hetohen. Për të bërë dallimin, duhet të shikohen motivet për nxjerrjen e një ligji për amnisti.
93. Fushëveprimi i një ligji për amnisti ndryshon si për nga ajo se cilat vepra mund të amnistohen, ashtu edhe për atë se për kë zbatohet, si dhe për periudhën kohore që përfshin ai. Megjithatë, si parim i përgjithshëm, një amnisti e miratuar nga Kuvendi duhet të respektojë parime të caktuara themelore të sundimit të ligjit, përkatësisht ligjshmërinë (duke përfshirë transparencën), ndalimin e arbitraritetit, mosdiskriminimin dhe barazinë para ligjit.
94. Sa i përket fushëveprimin të Ligjit për Amnisti, do të thotë për atë se për kë zbatohet, në përgjithësi ai mund të zbatohet për individët apo për një kolektiv.
95. Sa i përket veprave për të cilat zbatohet një ligj për amnisti, do të thotë për atë se cilat vepra penale mund të amnistohen dhe cilat nuk mund të amnistohen, është vërejtur se ekziston një listë e veprave aktuale penale sipas ligjit ndërkombëtar, si: shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjenocidin, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, torturat dhe zhdukjet, ku shtetet janë të detyruara që penalisht të ndjekin kryesit. Veprat penale të natyrës politike, që amnistohen, përfshijnë: tradhti, kryengritje, përmbysje, rebelim, përdorim i dokumenteve të rreme, falsifikim, propagandë antiqeveritare, posedim i armëve ilegale, spiunazh, anëtarësi në organizata të ndaluara politike apo fetare, dezertim dhe shpifje. Vepra penale të natyrës ekonomike, që amnistohen, janë të tilla si trafikim ilegal etj.
96. Pavarësisht nga fakti se mund të amnistohen disa vepra penale, është e pranuar ndërkombëtarisht që viktimat duhet të kenë të drejtë për qasje të barabartë dhe efektive në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin dëmshpërblimin adekuat, efektiv dhe të menjëhershëm për dëmin e pësuar, dhe duhet të kenë të drejtë për qasje efektive në informacionin relevant përkitazi me mekanizmat e reparacionit për shkelje të tilla.
97. Sa i përket periudhës kohore, mund të thuhet se, në përgjithësi, periudha kohore duhet të pasqyrojë objektivat e amnistisë në fjalë.
98. Megjithatë, siç u përmend më lart, ekziston një minimum kur nuk mund të jepet amnistia për shkelje të së drejtës për jetën dhe të drejtës së lirisë dhe sigurisë së personit, përfshirë të drejtën për liri nga tortura dhe nga format e tjera të keqtrajtimit. Në këtë drejtim, parimi i drejtësisë kërkon që duhet të ndreqen shkeljet e të drejtave të viktimës.
99. Gjykata vëren se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) herë pas herë është prononcuar për çështjen e pandëshkueshmërisë për shkeljet e të drejtës së lirisë nga keqtrajtimi dhe për shkeljet e të drejtës për jetën. Gjykata

rikujton aktgjykimin në rastin Eski kundër Turqisë (Kërkesa 8354/04, Aktgjykimi i 5 shtatorit 2012) ku, në lidhje me keqtrajtimin, GJENDJ-ja ka gjetur se:

“32. Gjykata rikujton se, në rastet kur një individ bën një deklaram të besueshëm se ka përjetuar trajtim në kundërshtim me nenin 3, në duart e policisë apo të përfaqësuesve të tjerë të shtetit, ajo dispozitë, e lexuar në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit nga neni 1 i Konventës, për t’ia ‘siguruar çdokujt brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në ... [këtë] Konventë’, kërkon në mënyrë implicite se duhet të ketë një hetim zyrtar efektiv. Një hetim i tillë duhet të jetë në gjendje të çojë deri te identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës (Shih, Labita kundër Italisë [GC], nr. [26772/95](#), § 131, ECHR 2000-IV). Sipas praktikës së vendosur gjyqësore, kjo do të thotë se autoritetet gjyqësore vendëse nuk duhet në asnjë mënyrë të jenë të përgatitura të lejojnë që vuajtjet e shkaktuara fizike dhe psikologjike të kalojnë pa u dënuar. Kjo është esenciale për të ruajtur besimin dhe mbështetjen e publikut për sundimin e ligjit dhe për parandalimin e çfarëdo pamje të tolerimit apo të bashkëpunimit nga ana e autoriteteve në akte të paligjshme (Shih, Okkali kundër Turqisë, nr. [52067/99](#), paragrafi 65, GJEDNJ 2006-XII (ekstrakte), dhe Derman, cituar më lart, paragrafi 27).

33. Pa dyshim se kërkesa për shpejtësi dhe për ekspeditim të arsyeshëm është implicite në këtë kontekst. Derisa mund të ketë pengesa apo vështirësi që parandalojnë përparimin në hetim në një situatë të caktuar, një reagim i shpejtë nga ana e autoriteteve në hetimin e pretendimeve për keqtrajtim mund të konsiderohet në përgjithësi si esencial për ruajtjen e besimit të publikut në respektimin e sundimit të ligjit dhe në parandalimin e çfarëdo pamjeje të tolerimit të akteve të paligjshme apo të bashkëpunimit në akte të tilla (Shih, Batı dhe të tjerët, citimi më lart, § 136).

34. Gjykata rikujton se, në rast se një përfaqësues i shtetit akuzohet për krime që cenojnë nenin 3, çdo procedurë penale dhe dënim pasues nuk duhet të jetë i parashkrueshëm dhe amnistimi apo falja nuk duhet të jenë të lejueshme. Më tej thekson se, në rastet kur një përfaqësues i shtetit është ngarkuar me vepra penale që përfshijnë torturën apo keqtrajtimin, është e një rëndësie të jashtëzakonshme që ai ose ajo të suspendohet nga detyra gjatë hetimit dhe gjykimit, dhe duhet të shkarkohet nëse dënohet (Shih, mutatis mutandis, Abdülsamet Yaman kundër Turqisë, nr. [32446/96](#), § 55, 2 nëntor 2004, dhe Serdar Güzel kundër Turqisë, nr. [39414/06](#), § 42, 15 mars 2011)”.

100. Gjykata, po ashtu, rikujton aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Sangariyeva dhe të tjerët kundër Rusisë (Kërkesa nr. 1839/04, Aktgjykimi i 1 dhjetorit 2008), ku, lidhur me të drejtën e jetës dhe me të drejtën për një zgjidhje, ka theksuar:

“74. Gjykata thekson se neni 2, që garanton të drejtën e jetës dhe përcakton rrethanat në të cilat justifikohet privimi nga jeta, radhitet si një nga dispozitat më themelore të Konventës nga e cila nuk lejohet asnjë derogim. Në dritën e rëndësisë së mbrojtjes që jepet me nenin 2, Gjykata duhet ta shqyrtojë privimin nga jeta me kujdesin më të madh, duke marrë parasysh

jo vetëm veprimet e përfaqësuesve të shtetit, por edhe rrethanat (Shih, ndër autoritete të tjera, McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykimi i 27 shtatorit 1995, Seria A, nr. 324, faqe 45-46, paragrafët 146-147).

[...]

106. Gjykata thekson se neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivel nacional të një mjete juridik për zbatimin e substancës së të drejtave dhe lirive nga Konventa në çfarëdo forme që ato ndodh të jenë siguruar në rendin juridik vendës. Duke marrë parasysh rëndësinë fundamentale të së drejtës për mbrojtje të jetës, neni 13 kërkon, përveç pagesës së kompensimit aty ku kërkohej, një hetim të detajuar dhe efektiv që është në gjendje të çojë deri te identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës për privimin nga jeta dhe shkaktimin e trajtimit që bie ndesh me nenin 3, përfshirë qasjen efektive të ankuesit në procedurën hetimore që do të çojë deri te identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës (Shih, Anguelova kundër Bullgarisë, nr. [38361/97](#), paragrafët 161-162, GJEDNJ 2002-IV, dhe Süheyyla Aydın kundër Turqisë, nr. [25660/94](#), paragrafi 208, 24 maj 2005). Gjykata më tej thekson se kërkesat nga neni 13 janë më të gjera se obligimi i një shteti kontraktues nga neni 2 për zhvillimin e një hetimi efektiv (Shih, Khashiyev dhe Akayeva, citimi më lart, paragrafi 183).

107. Rezulton që në rrethanat ku, sikurse këtu, hetimi penal i vdekjes së dhunshme ka qenë joefektiv dhe efektiviteti i çfarëdo mjete tjetër që ka mundur të ekzistojë, përfshirë mjetet civile, rrjedhimisht është rrezikuar, shteti ka dështuar në obligimin e tij nga neni 13 i Konventës”.

Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për amnistinë

Shqipëria

101. Sa i përket Shqipërisë, Gjykata thekson se Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 81.2(ë), përcakton që Ligji për Amnisti aprovohet me tri-të-pestat e deputetëve të Kuvendit.

102. Për këtë, Gjykata i referohet Dekretit nr. 7338, të 20 nëntorit 1989, dhe Ligjit mbi 'Pafajësinë dhe Amnistinë e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë', Nr. 7516 (30 shtator 1991), i ndryshuar me Ligjin Nr. 7660 (14 janar 1993) dhe me Ligjin Nr. 7719 (8 qershor 1993).

103. Dekreti nr. 7338, i 20 nëntorit 1989, thotë si në vijim:

“...

Neni 1. Falen personat e dënuar me heqje të lirisë gjer në 5 vjet, me dënime të tjera më të buta, si dhe ata që u është dhënë dënimi me kusht.

- 1. Nuk përfitojnë nga kjo pikë personat e dënuar për krime kundër shtetit sipas neneve 47 e 60 të Kodit Penal, për përvetësim ose grabitje të pasurisë socialiste sipas neneve 61 deri 68 të Kodit Penal, për vjedhje ose grabitje të pasurisë së shtetasve sipas neneve 101 e 102 të*

Kodit Penal, si dhe personat që janë dënuar edhe më parë me vendim të formës së prerë si përsëritës të veprave të ndryshme penale.

- 2. Falen të gjithë personat e dënuar, që më datën 20.11.1989 janë në moshë deri 18 vjeç.*
- 3. Falen personat e dënuar me heqje të lirisë, që me datën 20.11.1989 kanë mbushur moshën 60 vjeç.*
- 4. Falen të gjitha gratë e dënuara me heqje të lirisë deri në 15 vjet, me dënime të tjera më të buta, si dhe ato që u është dhënë dënimi me kusht.*

...”

104. Ligji mbi ‘Pafajësinë dhe Amnistinë e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë’, Nr. 7516 (30 shtator 1991), i ndryshuar me Ligjin Nr. 7660 (14 janar 1993) dhe me Ligjin Nr. 7719 (8 qershor 1993), thotë si në vijim:

“...

Neni 1

Të gjithë personat e dënuar për trazira dhe propagandë ndaj shtetit; ikje nga vendi; sabotimi; krijimi ose participimi në organizata politike; dështimi për të lajmëruar krime ndaj shtetit; shpifje dhe sharje ndaj organeve më të larta të shtetit dhe partisë; dhe shkeljes së Dekretit 7.459 Për Respektimin dhe Mbrojtjen e Monumenteve që Lidhen me Historinë Kombëtare dhe Simbolet Shtetërore dhe të Dekretit 7.408 Për Kuvendet, Tubimet dhe Demonstrimet e Qytetarëve në Vende Publike, janë të pafajshëm dhe konsiderohen si të padënuar për shkaqe morale, politike dhe shoqërore.

Neni 2

Të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë ikur nga Shqipëria për shkak të sanksionimit të tyre politik ose për veprimtarinë gjatë luftës ose për periudhën në mes të çlirimit dhe datës kur ky ligj ka hyrë në fuqi, dhe ata që nuk kanë kryer akte terroriste ose diversione që kanë quar në vdekje ose pasoja serioze, dhe të gjithë ata që kanë kaluar kufirin në mënyrë ilegale, janë të pafajshëm. Të gjithë të tjerët amnistohen.

Përfundim:

Personat e përjashtuar që janë dënuar për akte terrorizmi, të cilat kanë rezultuar me vdekje apo pasoja serioze. {Ligji Nr. 7660 (14 janar 1993)} përjashton ata të cilët janë dënuar për organizimin apo pjesëmarrjen në kryengritje, organizimin apo pjesëmarrjen në banda të armatosura, për aktivitete armiqësore gjatë luftës, organizimin apo pjesëmarrjen në konflikt ushtarak apo grusht shtet, për spiunazh, terror dhe diversion.

...

Bosnja e Hercegovina

105. Sa i përket Bosnjës e Hercegovinës, Gjykata vëren se Kushtetuta e saj nuk përmban dispozita përkitazi me amnistinë ose me faljen. Megjithatë, Marrëveshja për Paqe e Dejtonit, në shtojcën 7 – Marrëveshja për refugjatët dhe personat e zhvendosur, neni VI, thotë:

“Çdo refugjat ose person i zhvendosur i kthyer e që është i akuzuar për ndonjë krim, përveç shkeljeve të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar, siç definohet në Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë prej 1 janarit 1991 apo krimeve ordinere që nuk kanë të bëjnë me konfliktin, me rastin e kthimit do të amnistohet. Në asnjë rast, akuzat për krime nuk do të ngarkohen për shkaqe politike apo për arsye të papërshtatshme apo në mënyrë që të anashkalohet aplikimi i amnistisë”.

106. Rrjedhimisht, të dy entitetet e Bosnjës e Hercegovinës, Federata e Bosnjë e Hercegovinës dhe Republika Srpska, në korrik të vitit 1996, miratuan ligjet për amnisti. Sipas nenit 1 të Ligjin për Amnisti të Federatës: *“Duhet plotësisht t'i lirojë nga përndjekja penale ose plotësisht t'i lirojë nga dënimi i shqiptuar ose pjesa e dënimit që nuk e kanë vuajtur, të gjithë personat të cilët në periudhën prej 1 janarit 1991 deri më 22 dhjetor 1995 kanë kryer vepra penale të cilat janë paraparë në Kodin Penal përkatës (Neni 1)”. Amnistia përfshin pothuajse çdokënd që ka kryer vepër penale në periudhën prej 1 janarit 1991 deri më 22 dhjetor 1995, edhe pse disa krime shumë të rënda, të cekura në Ligjin Federal për Amnisti, nuk përfshihen: “Përjashtohen ‘veprat penale kundër njerëzimit dhe ligjit ndërkombëtar nën kapitullin XVI të Kodit Penal të aprovuar të RFSJ-së, krimet e definuara me Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë’. Përjashtohen aktet e gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, sikurse aktet terroriste, aktet kundër lirive seksuale, pengimi i kthimit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, dhunës në familje, pastrimit të parave dhe sulmit ndaj zyrtarit tatimor në detyrë”.*

Kroacia

107. Sa i përket Kroacisë, Gjykata thekson se Kushtetuta e Republikës së Kroacisë i jep kompetenca Dhomës së Përfaqësuesve për të amnistuar veprat penale (Neni 80 i Kushtetutës së Republikës së Kroacisë).
108. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet Ligjit kroat për Amnisti të Përgjithshme, të 20 shtatorit 1996, Nr. 80/96, ku thuhet:

“...

Ky akt jep amnisti të përgjithshme nga përndjekja dhe nga procedimet penale ndaj kryesve të veprave penale të kryera gjatë agresionit, kryengritjes së armatosur apo konfliktit të armatosur, ose që kanë të bëjnë me agresionin, kryengritjen e armatosur apo konfliktin e armatosur në Republikën e Kroacisë. Amnistia gjithashtu ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve të prera kundër kryesve të veprave penale të cekura në

paragrafin 1 të këtij neni. Amnistia nga përndjekja dhe nga procedimet penale lidhet me veprat e kryera në periudhën prej 17 gushtit 1990 e deri më 23 gusht 1996.

Neni 2

Nuk do të ndërmerren përndjekje penale dhe nuk do të iniciohen procedime penale kundër kryesve të veprave penale të cilat përmenden në nenin 1 të këtij akti. Nëse është ndërmarrë ndjekja penale, ajo duhet të ndalet, dhe nëse procedura penale është iniciuar, procedura duhet të stopohet ex officio me vendim të gjykatës. Nëse një person ka lidhje me amnistinë nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilit i është hequr liria, ky person duhet të lirohet me vendim të gjykatës.

Neni 3

Amnistia për veprat penale të cilave u referohet neni 1 i këtij akti përjashton kryesit e shkeljeve më të rënda të ligjit humanitar që përmbajnë karakteristikat e krimeve të luftës, veçanërisht veprat penale të gjenocidit sipas nenit 119, krimet e luftës kundër popullatës civile sipas nenit 120, krimet e luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve sipas nenit 121, krimet e luftës ndaj të burgosurve të luftës sipas nenit 122, organizimi i grupeve dhe nxitja e kryerjes së gjenocidit dhe krimeve të luftës sipas nenit 123, vrasja dhe plagosja e paligjshme e armikut sipas nenit 124, konfiskimi i paligjshëm i pasurisë që i përket të vvarëve dhe të plagosurve në fushëbetejë sipas nenit 125, përdorimi i mjeteve të ndaluara luftarake sipas nenit 126, cenimi ndaj parlamentarëve sipas nenit 127, trajtimi mizor i të plagosurve, të sëmurëve dhe të burgosurve të luftës sipas nenit 129, shkatërrimi i monumenteve kulturore dhe historike sipas nenit 130, nxitja e luftës dhe agresionit sipas nenit 131, abuzimi i simboleve ndërkombëtare sipas nenit 132, diskriminimet raciale dhe të tjera sipas nenit 133, krijimi i skllavërisë dhe transportimi i skllavëve sipas nenit 134, terrorizmi ndërkombëtar sipas nenit 135, rrezikimi i personave nën mbrojtjen ndërkombëtare sipas nenit 136, marrja e pengjeve sipas nenit 137 të Kodit Penal Bazë të Republikës së Kroacisë (Narodne Novine, Nr. 31/93 – tekst i korigjuar, 35/93, 108/95, 16/96 dhe 28/96), si dhe veprat penale të terrorizmit të rregulluara me dispozitat e së drejtës ndërkombëtare. Amnistia përjashton kryesit e veprave të tjera penale të përcaktuara në Kodin Penal Bazë të Republikës së Kroacisë (Narodne Novine, Nr. 31/93 – tekst i korigjuar, 35/93, 108/95, 16/96 dhe 28/96) dhe në Ligjin Penal të Republikës së Kroacisë (Narodne Novine, Nr. 32/93 – teksti i korigjuar, 38/93, 28/96 dhe 30/96), të cilat nuk janë kryer gjatë agresionit, kryengritjes së armatosur ose konfliktit të armatosur në Republikën e Kroacisë.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Penale (Narodne Novine, Nr. 34-93 – teksti i korigjuar, 38/93, 25/94 dhe 28/96) mbi përsëritjen e procedurës, do të aplikohen për personat të cilët janë dënuar në mungesë me vendim të formës së prerë për veprat penale nga paragrafi 1 i këtij neni, ku afati nga neni 398, paragrafi 1, i atij ligji fillon kur ky akt hyn në fuqi.

...”

Greçia

109. Sa i përket Geqisë, Gjykata vëren se neni 47(3) i Kushtetutës përcakton se amnisti mund të jepet vetëm për krime politike, me aktin e aprovuar nga Plenumi i Parlamentit me shumicë prej tri-të-pestave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Megjithatë, neni 47(4) parasheh që amnistia, në rast të krimeve ordinere, nuk mund të jepet as me ligj”.

Maqedonia

110. Në Republikën e Maqedonisë, neni 68 i Kushtetutës përcakton që amnistitë i shpall Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.
111. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet Ligjit maqedonas për Amnisti, të 7 marsit 2002, i cili thotë:

“...

Neni 1

Ky ligj përjashton, ndërpret, procedurat penale dhe plotësisht përjashton nga ekzekutimi i dënimit me burgim (tutje: amnisti), qytetarët e Republikës së Maqedonisë, personat rezidentë të ligjshëm, si dhe personat që kanë pasuri apo familje në Republikën e Maqedonisë (tutje: personat), për të cilët ekziston dyshim i arsyeshëm që ata kanë përgatitur apo kanë kryer vepra penale të lidhura me konfliktin e vitit 2001, duke përfunduar më 26 shtator 2001.

Amnistia gjithashtu aplikohet te personat që kanë përgatitur apo që kanë kryer vepra penale të lidhura me konfliktin e vitit 2001, para 1 janarit 2001.

Me amnistinë e përmendur, në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni:

- Personat për të cilët ekziston dyshim i arsyeshëm se kanë përgatitur apo kanë kryer vepra penale të lidhura me konfliktin deri më 26 shtator 2001, përjashtohen nga përndjekja për vepra penale sipas Kodit Penal dhe sipas ligjeve të tjera të Republikës së Maqedonisë;*
- Ndërpriten procedurat penale për veprat penale, sipas Kodit Penal dhe sipas ligjeve të tjera të Republikës së Maqedonisë, kundër personave për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm se kanë përgatitur apo kanë kryer vepra penale të lidhura me konfliktin deri më 26 shtator 2001;*
- Personat, të cilët kanë përgatitur apo kanë kryer vepra penale që kanë të bëjnë me konfliktin deri më 26 shtator 2001, përjashtohen plotësisht nga ekzekutimi i dënimit me burgim për veprat penale sipas Kodit Penal dhe sipas ligjeve të tjera të Republikës së Maqedonisë; dhe*

- *Është vendosur që vendimi për sanksionim të fshihet dhe pasojat ligjore të vendimit sanksionues të shfuqizohen, duke përfunduar më 26 shtator 2001.*

Krimet që përjashtohen nga amnistia:

Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nuk aplikohen te personat që kanë kryer vepra penale që kanë të bëjnë dhe janë të lidhura me konfliktin e vitit 2001, të cilat janë nën juridiksionin dhe për të cilat do të iniciojë procedura Tribunali për Përndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkeljet e Rënda të të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë së vitit 1991.

...

112. Nga shembujt e sipërpërmendur, Gjykata thekson se shtetet e ndryshme kanë zgjedhur metoda të ndryshme për rregullimin e çështjes së amnistisë, si në kushtetutat e tyre ashtu edhe me ligjet përkatëse. Disa shtete (Maqedonia, Kroacia) kanë zgjedhur në kushtetutat e tyre një formulim të përgjithshëm për dhënien e kësaj kompetence parlamentit kombëtar, përderisa Greqia specifikon se cilat krime nuk mund të amnistohen në asnjë rrethanë, sikurse janë krimet ordinere. Në anën tjetër, Kushtetuta e Shqipërisë përmban një formulim të përgjithshëm, por shton se Ligji për Amnisti nuk mund t'i nënshtrohet referendumit.
113. Ligjet për amnisti të disa vendeve të tjera, në mënyrë specifike, përfshijnë krimet politike apo krimet që janë të lidhura me konfliktet, duke iu referuar kontekstit faktik, pa iu referuar konkretisht veprave të përshkruara. Për shembull, një amnisti e vitit 1993 në Liberi, përfshinte *“të gjithë personat dhe palët e përfshira në konfliktin civil të Liberisë”*, kurse një amnisti e Angolës, e vitit 1994, përfshinte *“veprat e paligjshme të kryera ... në kontekstin e e konfliktit aktual”*, dhe një amnisti e Shqipërisë, e vitit 1997, përfshinte *“krimet e lidhura me revoltë popullore”*.
114. Një qasje tjetër, e cila është më e zakonshme dhe më e besueshme, i përfshin të dyja, duke iu referuar edhe kontekstit apo ngjarjes specifike dhe shprehimisht duke kufizuar aplikimin e tij në lloje të veçanta të veprave. Për shembull, në disa raste, është dhënë pa ndonjë referencë për motivimin e një personi një listë e plotë e veprave specifike penale të një natyre në thelb politike. Kështu, një amnisti në Brazil, në vitin 1979, përfshinte dezertimin ushtarak dhe një sërë veprash të tjera penale, në thelb politike, pa iu referuar ndonjë motivimi. Në raste të tjera, veprat penale specifike politike janë të shënuara, por në një mënyrë joshteruese. Amnistia e Francës, e vitit 1962, përfshinte shkeljet e kryera në kontekst të operacioneve për ruajtjen e rendit dhe të drejtuara kundër kryengritjes algjeriane, me kusht që ato të ishin kryer para 20 marsit 1962. Amnistia e Greqisë, e vitit 1974, përfshinte një mori krimesh të veçanta, siç janë kryengritja dhe tradhtia, të cilat janë të dënueshme me Kodin Penal dhe me Kodin Ushtarak, së bashku me *“vepra të tjera që kanë të bëjnë me situatën e 21 prillit 1967, që kanë pasur për qëllim rrënimin e status quo-s”*.

115. Megjithatë, ka raste kur ligjet e amnistisë kanë shprehur qartë se kërkohet elementi i motivimit politik për dhënien e amnistisë për një vepër penale. Për shembull, amnistia e vitit 1990, në Rumani, përfshinte shkelje politike të definuara si *“vepra që kanë pasur si qëllim: (a) protestën kundër diktaturës, kultit të personalitetit, terrorit apo abuzimit të pushtetit nga autoritetet; (b) respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, realizimin e të drejtave politike, ekonomike, sociale dhe kulturore apo shfuqizimin e praktikave diskriminuese; (c) përmbushjen e kërkesave demokratike”*. Amnistia e vitit 1995, në Afrikën e Jugut, përfshinte akte, lëshime dhe vepra *“që ndërlidhen me objektivat politike dhe të kryera gjatë konflikteve në të kaluarën”*, dhe pastaj jepte një listë të gjatë të kriterëve përkatëse. Ajo listë, çka është me rëndësi, përfshinte kërkesën për proporcionalitet ndërmjet aktit (politik) dhe objektivit politik. Në raste të tjera, nga ana tjetër, kërkesa për motivim politik shprehet më thjesht. Për shembull, amnistia e vitit 1996, në Guatemalë, thjesht parashihte që, për aktorët shtetërorë, vepra penale duhet të ketë pasur motiv politik dhe jo personal. Amnistia e vitit 2000, në Filipine, përfshinte veprat e kryera penale për *“realizimin e besimeve politike”*, shprehimisht përjashtonte veprat penale të kryera për *“qëllime personale”*.
116. Në pikëpamje të referencave të mësipërme, Gjykata është e mendimit se, në përgjithësi, amnistia mund të jepet për një sërë arsyesh. Edhe pse duket se amnistia është dhënë zakonisht për vepra që konsiderohen politike, apo të lidhura me një konflikt të veçantë, por ka edhe amnisti për krime ekonomike ose të zakonshme. Megjithatë, ajo që duhet të jetë qenësore në të gjitha ligjet e amnistisë, është qartësia dhe transparenca. Jo vetëm kryesit e amnistuar të krimeve konkrete kanë të drejtë të dinë se si do të aplikohet për ta ligji relevant i amnistisë, por edhe viktimat e krimeve të tilla kanë të drejtë të dinë se në çfarë mënyre do të marrin reparacionin ose kompensimin për dëmet që u janë shkaktuar, por të dinë edhe atë se nëpërmjet cilëve mekanizma ligjorë efektivë dhe efikas do ta realizojnë këtë.
117. Gjykata vëren se paragrafi 1 i nenit 2 [Amnistia] i Ligjit për Amnisti përcakton se *“të gjithë kryesve të veprave penale, të listuara në nenin 3 të këtij ligji, të cilat janë kryer para datës 20 qershor 2013, u jepet lirim i plotë nga ndjekja penale apo nga ekzekutimi i dënimit, në përputhje me kushtet e parapara me nenin 3 të këtij ligji”*.
118. Gjykata është e mendimit se kjo mund vetëm të nënkuptojë që kryesit e veprave penale, të përmendur nga Ligji, më nuk do të jenë të dënuar për kryerjen e veprave të tilla, por do të vazhdojnë të mbahen përgjegjës për dëmet që kanë shkaktuar apo për përmbushjen e obligimeve që kanë lënë pas dore. Qëllimi i ligjvënësit që të sigurojë se rezultatet e veprave penale nuk do të preken nga amnistia për veprën penale, mund të vetëkuptohet duke iu referuar nenit 9 [Plotfuqishmëria e konfiskimit] të Ligjit për Amnisti, i cili përcakton:

“Pavarësisht aplikueshmërisë së amnistisë ndaj çfarëdo vepre penale sipas këtij ligji, nëse një send është konfiskuar në përputhje me ligjin gjatë procedurës penale bazuar plotësisht apo pjesërisht në atë vepër penale, personi i cili përfiton nga amnistia nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e sendit të konfiskuar”.

119. Sipas Gjykatës, për shembull, taksapaguesit që përfshihen brenda nenit 3 të Ligjit, nuk duhet të presin që nuk do të kenë më nevojë të paguajnë obligimet e tyre ndaj autoriteteve tatimore të Kosovës që i kanë pasur deri më 20 qershor 2013. Përkundrazi, neni 2 i Ligjit mund vetëm të kuptohet se, edhe pse shmangësit e tatimeve nuk do të penalizohen, ata nuk amnistohen nga korrigjimi i mospagimit të tatimeve. Nëse po, atëherë, kjo do të krijonte pabarazi ndër taksapagues. E njëjta gjë vlen edhe për krimet për përfitime/lakmi personale.
120. Në frymë të njëjtë, kryesit e veprave të amnistuara, që u kanë shkaktuar dëme palëve të treta, duhet të mbeten përgjegjës për pagesën e kompensimit ndaj viktimës, e cila duhet të ketë mjete efikase dhe efektive juridike për t'i përmbushur të drejtat e veta.
121. Gjithashtu, në rastet kur amnistohen, për shembull, kryesit e falsifikimeve të dokumenteve, por kur Ligji qëndron i heshtur për mënyrën se si mund të asgjësohen produktet e krimit të amnistuar, duhet të jetë në dispozicion një mekanizëm, ku produktet e krimit të amnistuar mund të identifikohen dhe të nxirren jashtë qarkullimit dhe të asgjësohen. Nëse jo, atëherë, këto produkte rrezikojnë të vazhdojnë të përdoren si provë, duke komprometuar themelet juridike të Kosovës, si shtet ku sundon ligji.
122. Duke pasur parasysh këto vlerësime dhe qëllimet e ligjit të lartpërmendur, Gjykata tani do të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Ligjit për Amnisti, Nr. 04/L-209, të miratuar nga Kuvendi më 11 korrik 2013.

Meritat e kërkesës

123. Gjykata vëren se parashtruesit pretendojnë që Ligji për Amnisti, Nr. 04/L-209, shkel Kushtetutën sa i përket përmbajtjes së tij dhe procedurës së ndjekur për miratimin e Ligjit.

Sa i përket aspektit përmbajtjesor të ligjit të kontestuar

124. Parashtruesit e kërkesës, përkitazi me veprat e amnistuara me Ligjin për Amnisti, pretendojnë se ato janë në kundërshtim me nenin 31, paragrafi 1 e paragrafi 2; me nenin 32 dhe me nenin 24, paragrafi 1 e paragrafi 2, të Kushtetutës; si dhe në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, në lidhje me nenet 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ). Parashtruesit e kërkesës, po ashtu, pretendojnë se disa nga veprat e amnistuara penale janë në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit të Parë të KEDNJ-së.
125. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në paragrafin 1 e në paragrafin 2, parasheh:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

126. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës parasheh:

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

127. Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, në paragrafin 1 e në paragrafin 2, parasheh:

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal...”.

128. Neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, në fjalinë e parë relevante, parasheh:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”.

129. Neni 13 i KEDNJ-së parasheh:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara me këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

130. Neni 14 i KEDNJ-së parasheh:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara me këtë konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

131. Neni 1, i Protokollit të Parë, të KEDNJ-së parasheh:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

132. Megjithatë, Gjykata, së pari do t'i bëjë disa vërejtje paraprake sa i përket parimeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me amnistinë.
133. Si vërejtje të parë paraprake, Gjykata rikujton nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar”.

134. Sa i përket kësaj, Gjykata vëren, siç është shprehur në Rastin Nr. KO131/12 (Shih rasti KO131/12, parashtrues i kërkesës dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 15 prillit 2013) që një ligj, kur i kufizon të drejtat dhe liritë, duhet t'i përmbushë kërkesat e caktuara me nenin e lartpërmendur.
135. Si vërejtje të dytë paraprake, Gjykata rikujton rastin *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* (Kërkesa nr. 38433/09, Aktgjykim i 7 qershorit 2012), ku GJEDNJ-ja ka konstatuar:

“141. [...] një normë nuk mund të konsiderohet si një ‘ligj’ përveç nëse është formuluar me përpikëri të mjaftueshme për t'i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje, nëse ka nevojë me këshillimin e duhur – që të parashikojë, deri në një shkallë që është e arsyeshme sipas rrethanave, pasojat që mund të sjell një veprim i caktuar. Këto pasoja nuk duhet të jenë të parashikueshme me siguri absolute: përvoja tregon që kjo të jetë e paarritshme. Përsëri, përderisa siguria është shumë e dëshirueshme, ajo mund të sjell në rrjedhën e vet rigozitet të

tepruar dhe ligji duhet të jetë në gjendje të ecë në hap me rrethanat që ndryshojnë. Prandaj, shumë ligje janë vënë në letër me formulime që, në një masë më të madhe ose më të vogël, janë të paqarta dhe interpretimi dhe zbatimi i të cilave është çështje e praktikës. Niveli i saktësisë që kërkohet nga legjislacioni vendës – që gjithsesi nuk mund të parashikojë çdo eventualitet – varet në masë të konsiderueshme nga përmbajtja e ligjit në fjalë, nga fusha për të cilën është projektuar ta mbulojë, si dhe nga numri dhe statusi i atyre të cilëve u adresohet”.

Amnistia dhe sundimi i ligjit – Vërejtje të përgjithshme

136. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës kanë të bëjnë kryesisht me të drejtën e viktimave të veprave të amnistuara penale për të pasur qasje në gjykata për të kërkuar reparacion për dëmet që mund të kenë përjetuar si rezultat i këtyre veprave të amnistuara penale. Në thelb, ky është një argument që ka të bëjë me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6(1) të KEDNJ-së.
137. Siç u theksua më lart, e drejta për mjet juridik, siç parashihet me nenin 32 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së, kërkon që dëmi që ka pësuar një individ të mund t'i atribuohet shtetit dhe/ose përfaqësuesve të tij. Çdo krim që arrin nivelin e shkeljes së rëndë të së drejtës për jetë apo të lirisë nga keqtrajtimi, po ashtu përjashtohet nga amnistia me nenin 4 të Ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se e drejta për mjet juridik nuk vlen për veprat penale të parapara me Ligjin për Amnisti, dhe ky argument duhet të hedhet poshtë si qartazi i pabazuar. Për të njëjtat arsye, argumentet përkitazi me diskriminimin që lidhet me të drejtën për mjet juridik, siç garantohet me nenin 14 të KEDNJ-së, po ashtu duhet të hedhen poshtë si qartazi të pabazuara.
138. Sa i përket të drejtës për qasje në gjykatë, Gjykata merr parasysh Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar (Kërkesa 8225/78, Aktgjykimi i 28 majit 1985), ku GJEDNJ-ja theksoi:

“57. [...] Sigurisht, e drejta e qasjes në gjykata nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve; këto lejohen në mënyrë implicite pasi që e drejta e qasjes 'për nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga ana e shtetit, rregullim që mund të ndryshojë në kohë dhe në vend, varësisht nga nevojat dhe resurset e komunitetit dhe individëve' (Shih Aktgjykimin e lartpërmendur, Golder, fq. 19, paragrafi 38, që citon Aktgjykimin 'Linguistik Belg', të 23 korrikut 1968, Seria A, nr. 6, fq. 32, paragrafi 5). [...]

Megjithatë, kufizimet e zbatuara nuk duhet të kufizojnë apo të zvogëlojnë qasjen që i është lënë individit në atë mënyrë apo deri në atë masë sa të cenohet vetë esenca e kësaj të drejte. [...]

Për më tepër, një kufizim nuk do të jetë në pajtim me nenin 6, paragrafi 1 (neni 6-1), nëse nuk ka një cak legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet”.

139. Çështja që shtrohet është nëse amnistia e paraparë me Ligjin për Amnisti do të kufizonte apo do të zvogëlonte mundësinë që u është lënë individëve për t'iu qasur gjykatës deri në atë masë sa të cenohet pikërisht esenca e kësaj të drejte.

140. Gjykata rikujton Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Tarbuk kundër Kroacisë (Kërkesa nr. 31360/10, Aktgjykimi i 29 prillit 2013), ku GJEDNJ-ja, në lidhje me amnistinë, ka gjetur se

“50. [...] Për më tepër, organet e Konventës tashmë kanë marrë qëndrim që, edhe në fushat themelore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, siç është e drejta për jetën, shteti ka të drejtë të miratojë, në kontekst të politikës së vet penale, çfarëdo ligji të amnistisë që e konsideron të arsyeshëm, mirëpo me kusht që të ruhet balancimi në mes të interesave legjitime të shtetit dhe të interesave të pjesëtarëve individualë të publikut (Shih, Dujardin dhe të tjerët kundër Francës, Nr. 16734/90, Vendim i Komisionit i 2 shtatorit 1991, Vendime dhe Raporte 72, fq. 236)”.

141. Gjykata vëren se individët që kanë pësuar dëm, si rezultat i veprave të amnistuara penale, në parim, do të mund të kishin qasje qoftë në kërkesën për ndjekje, për ndjekje private ose për ndjekje subsidiare për një vepër penale (varësisht se cili ligj penal ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në raste të caktuara), ose në padi civile për kompensim kundër kryesve. Gjykata vëren, në këtë kuptim, se neni 5 i Ligjit për Amnisti përcakton: *“Me dhënien e amnistisë nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në dënim apo në aktgjykim”.*

142. Për më tepër, Gjykata vëren se, në ato raste ku është iniciuar ndjekja private para hyrjes në fuqi të Ligjit për Amnisti dhe të cilat nuk e kanë arritur përfundimin, ato ndjekje private mund të vazhdojnë.

143. Ajo çfarë mbetet është çështja nëse individët që pohojnë se kanë pësuar dëm, si rezultat i një veprë penale që ka përfituar nga amnistia, do të vazhdojnë të kenë mundësi të paraqesin padi civile për kompensim nëpër gjykatat civile.

144. Gjykata rikujton nenin 136 [Bazat e Përgjegjësisë] të Ligjit mbi Detyrimet (Ligji Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 16/19, Qershor 2012), që përcakton:

“1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”.

145. Kjo dispozitë e përgjithshme u lejon viktimave të dëmtuara qasje në procedurë civile për dëmin e shkaktuar nga kryesit e veprave penale që parashihen të amnistohen me Ligjin për Amnisti. Marrëdhënia ndërmjet procedurave eventuale civile për kompensim, ku dëmi është rezultat i veprës penale, dhe procedurave penale ndaj kryesit, është e rregulluar me Ligjin për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006), i cili, në nenin 14, përcakton:

“Në procedurën kontestimore, gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin

e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”.

146. Në këtë drejtim, Gjykata bën këto vërejtje:

1) Ligji për Amnisti përcakton në nenin 5 që, në rastet kur dikush tashmë është dënuar por që tani amnistohet, amnistia nuk do të ndikojë në të drejtat e palëve të treta (pra, të viktimave).

2) Neni 14 i Ligjit për Procedurën Kontestimore thotë se gjykata civile është e lidhur me vendimin e gjykatave penale *“në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale”*. Viktima që ndërmerr procedurë civile për kompensim, nuk kërkon nga gjykata që të nxjerr të gjetura përkitazi me përgjegjësinë penale ose me veprat penale.

3) Neni 14, po ashtu, thotë se *“gjykata është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Megjithatë, pas amnistisë nuk ka fare aktgjykim të ndonjë gjykate për përgjegjësinë penale, kështu që nuk ka aktgjykim të cilin gjykata civile do ta marrë parasysh apo me të cilin do të jetë e lidhur ajo.

147. Prandaj, Gjykata vëren se, në rastet kur një i pandehur më herët është shpallur fajtor për një vepër penale, veprimi i nenit 5 të Ligjit për Amnisti do të sigurojë që individët të cilët kërkojnë kompensim, si rezultat i asaj vepre, do të mbanin të drejtat për të kërkuar kompensim në procedura civile.

148. Mirëpo, në rastet kur nuk ka përfunduar ndjekja penale dhe kur nuk ka përcaktim nga gjykata penale të fajësisë ose të pafajësisë, efekti i amnistisë do të nënkuptonte që kurrë nuk do të ketë përcaktim të fajësisë.

149. Në mungesë të përcaktimit të përgjegjësisë penale, shtrohet pyetja se a mund të ushtrohet efektivisht e drejta për përcaktimin e detyrimeve civile për kompensim nga ana e një gjykate. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shpesh ka theksuar se *“[...] Konventa ka për qëllim të garantojë jo të drejtat që janë teorike ose iluzore por të drejtat që janë praktike dhe efektive; [...]”* (Shih Artico kundër Italisë, Kërkesa nr. 6694/74, Aktgjykim i 13 majit 1980, paragrafi 33).

150. Në dritën e përcaktimit nga neni 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe në mungesë të argumenteve bindëse për të kundërtën, Gjykata konsideron se mund të mos sigurohen të drejtat e viktimave të një vepre penale për qasje praktike dhe efektive në gjykatë civile për të paraqitur kërkesë për kompensim për dëme kur nuk ka pasur gjykim penal paraprak. Gjykata gjen se mundësitë për kompensim civil mund të mos garantojnë perspektivë për procedurë të suksesshme civile pa pasur gjykim penal dhe aktgjykim të formës së prerë.

151. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se, në disa lloje të veprave penale që parashihet të përfitojnë nga amnistia, ku dëmi mund të jetë shkaktuar ndaj individëve, dispozitat përkatëse të Ligjit për Amnisti praktikisht do të bllokoni qasjen praktike dhe efektive të këtyre individëve në gjykata për të zgjidhur

kërkesat e tyre për kompensim të dëmeve, duke ua cenuar të drejtat e tyre nga neni 31 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së.

152. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të së drejtës për gëzimin paqësor të pronës nga neni 1, Protokollit i Parë, i KEDNJ-së, si rezultat i amnistimit të veprave të caktuara penale, të parapara me Ligjin për Amnisti.
153. Gjykata vëren se e drejta e gëzimit të papengueshëm të pronës ka të bëjë me ndërhyrjet në këtë të drejtë nga ana e shtetit ose nga përfaqësuesit e shtetit. Veprat penale në fjalë kanë të bëjnë me dëmin në pronë, të shkaktuar nga individët privatë në kontekst të kryerjes së veprës penale. Megjithatë, fakti që vetë Ligji për Amnisti parashihet amnisti për vepra penale të kryera ndaj pronës private, kështu që vendimet e mëpastajme nga organet e prokurorisë dhe të gjyqësisë për të dhënë amnisti në bazë të këtij Ligji shkaktojnë ndërhyrje në të drejtën e pronës brenda fushëveprimit të përgjegjësive të shtetit.
154. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se, në disa lloje të veprave penale që parashihet të përfitojnë nga amnistia, ku dëmi ndaj pronës i është shkaktuar individëve, këto dispozita të Ligjit për Amnisti praktikisht cenojnë të drejtën e gëzimit të papengueshëm të pronës, e drejtë kjo që mbrohet me nenin 1 të Protokollit të Parë të KEDNJ-së.

Vlerësimi nen për nen i Ligjit për Amnisti

155. Gjykata tani do të analizojë secilin prej neneve të Ligjit për Amnisti dhe secilin propozim për amnistimin e veprave penale.

I. Neni 1 (Qëllimi dhe fushëveprimi)

“Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurën me të cilën jepet amnisti për personat të cilët janë dënuar për një vepër penale, personat të cilët janë nën ndjekje penale për vepra penale, apo personat të cilët mund të jenë objekt i ndjekjes penale për veprat penale të kryera para 20 qershorit 2013 brenda territorit që tani përbën Republikën e Kosovës”.

156. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, që përcakton: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; [...]”.

157. Neni 8 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut përcakton: *“Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet”.*

158. Sa i përket kësaj, Gjykata i referohet parimeve të përcaktuara dhe praktikës së Kombeve të Bashkuara në lidhje me amnistinë, siç përmbledhen në Publikimin e Kombeve të Bashkuara, “Mjetet e Sundimit të Ligjit për Shtetet Pas Konfliktit – Amnistinë” (Nju-Jork dhe Gjenevë, 2009, HR/PUB/09/1), duke marrë së bashku amnistinë e vendosura, korpuset e parimeve dhe jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare. Kjo përmbledhje e parimeve përcakton, në faqen 11, që amnistinë nuk janë të lejuara, nëse ato:

(a) Pengojnë/parandalojnë ndjekjen e individëve të cilët mund të jenë përgjegjës për krime lufte, gjenocid, krime kundër njerëzimit ose shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe shkeljet specifike gjinore;

(b) Ndërhyjnë në të drejtën e viktimës për një mjet efektiv, duke përfshirë edhe reparacionin; ose

(c) Kufizojnë të drejtën e viktimave dhe shoqërive për të kuptuar të drejtën në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare.

159. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Ligji për Amnisti, në nenin 4, përcakton veprat e caktuara penale që nuk do të përfitojnë nga amnistia. Ky nen parasheh:

“1. Amnistia nga cilado vepër penale e përmendur në këtë ligj nuk do të aplikohet për:

1.1 Veprat kundër aktorëve ndërkombëtarë dhe forcave ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë. Anëtarët e forcave ndërkombëtare të sigurisë janë gjithmonë nën juridiksionin e shtetit dërgues;

1.2 Veprat të cilat përbëjnë shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare përfshirë ato vepra penale të Kapitullit XV të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kapitullit XIV të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Kapitullit XVI të Kodit Penal të RSFJ 1976;

1.3 Veprat penale që kanë rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje”.

160. Gjykata konsideron se fushëveprimi i Ligjit për Amnisti, siç është përcaktuar në nenin 1 të tij, në mënyrë të qartë është në kuadër të normave ndërkombëtare në lidhje me amnistinë dhe siguron kufizime për veprat penale të parapara për amnistinë dhe, për këtë, Ligji mbetet brenda kufijve të këtyre normave.

II. Neni 2 i Ligjit për Amnisti parasheh:

“1. Të gjithë kryesve të veprave penale të listuara në nenin 3 të këtij ligji të cilat janë kryer para datës 20 qershor 2013 u jepet lirim i plotë nga ndjekja penale apo nga ekzekutimi i dënimit, në përputhje me kushtet e parapara me nenin 3 të këtij ligji.

2. Amnistia sipas këtij ligji mund të jepet vetëm në përputhje me procedurat e parapara në Kapitullin III të këtij ligji”.

161. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, siç theksohet më lart, një ligj i miratuar duhet të formulohet me precizitet të mjaftueshëm për t'i mundësuar qytetarit që të rregullojë sjelljen e tij, që do të thotë se ai duhet të jetë në gjendje të parashohë, në një masë që është e arsyeshme për rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Për më tepër, një ligj duhet të formulohet qartë në mënyrë të mjaftueshme, në mënyrë që qytetarët të parashohin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës ligji do të jetë në fuqi.
162. Sa i përket përcaktimit të periudhës kohore për të cilën do të vlejë Ligji për Amnisti, Gjykata i referohet nenit 2, paragrafi 1, të Ligjit për Amnisti, që përcakton se do të amnistohen veprat penale (të përmendura në nenin 3 të Ligjit për Amnisti), të kryera deri më 20 qershor 2013.
163. Ky nen nuk përmban ndonjë dispozitë eksplicite përkitazi me datën e fillimit prej kur do të amnistoheshin veprat penale. Megjithatë, Gjykata merr parasysh kodet penale për të cilat do të vlejnjë amnistitë. Këto përmenden me radhë në Ligjin për Amnisti dhe konkretisht përfshihen këto kode:
- a. Kodi Penal i Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (RFSJ), Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 44, 8 tetor 1976;
 - b. Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), Gazeta Zyrtare, nr. 20/77;
 - c. Rregulloret e UNMIK-ut 1999/24 dhe 2000/59 për Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, që përcaktojnë se Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 dhe Ligji Penal i KSAK i vitit 1977 janë ligj i aplikueshëm penal në Kosovë me hyrjen në fuqi më 10 qershor 1999;
 - d. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 për Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004; dhe
 - e. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare, nr. 19/13 2012, që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.
164. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, duke marrë parasysh përmendjen specifike të këtyre kodeve dhe të ligjeve penale, është mjaft e qartë se ligjvënësi ka pasur qëllim që Ligji për Amnisti të vlejë vetëm për periudhën sa kanë qenë të aplikueshme këto kode të cekura. Rrjedhimisht, lehtë mund të interpretohet se data e fillimit të Ligjit për Amnisti në mënyrë implicite kuptohet të jetë 10 qershori 1999. Një konkludim i tillë është edhe më i qartë kur merret parasysh se legjislacioni penal, që është zbatuar në territorin e Kosovës pak para datës 10 qershor 1999, nuk përmendet në Ligjin për Amnisti.
165. Për aq sa mund të konsiderohet që amnistia vlen për veprat e kryera penale gjatë viteve të '70-ta dhe të '80-ta, kur Kodi Penal i RSFJ-së dhe Ligji Penal i KSAK kanë qenë fillimisht në fuqi, Gjykata vëren se veprat e tilla penale do të përfitonin nga periudha e parashkrimit, përveç rasteve të caktuara të krimeve shumë të rënda, për të cilat Ligji për Amnisti nuk parasheh se do të përfitojnë nga amnistia.

166. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se periudha e zbatimit, që përmban neni 2, paragrafi 1, i Ligjit për Amnisti, është e definuar mjaft qartë, për të qenë në përputhje me kërkesat e sigurisë juridike në pajtim me parimin e sundimit të ligjit.

III. Neni 3 (Kushtet për dhënien e amnistisë nga ndjekja penale dhe vuajtja e plotë e dënimit)

“1. Lirohen plotësisht nga ndjekja penale apo vuajtja e plotë e dënimit, kryesit e veprave të mëposhtme penale:

1.1. Veprat penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 19/13, Korrik 2012)”.

167. Neni 438 (Vazhdimësia e sanksioneve penale) i Kodit të tanishëm Penal të Kosovës përcakton: *“Të gjitha sanksionet penale për veprat të cilat edhe me këtë kod janë të ndëshkueshme dhe të shqiptuara me aktgjykim të formës së prerë para hyrjes në fuqi të këtij kodi vazhdojnë me kohëzgjatje dhe lartësi të njëjtë”.*

168. Për më tepër, neni 439 (Shfuqizimi i akteve ligjore dhe nënligjore) i Kodit të tanishëm Penal të Kosovës parasheh: *“Me hyrjen në fuqi të këtij kodi, shfuqizohen Rregulloret e UNMIK-ut dhe Kodi Penal i Kosovës (UNMIK REG 2003/05) si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që mbulojnë çështjet e trajtuara në këtë kod”.*

1.1.1 Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës (Neni 121), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me kryerjen e një vepre tjetër penale për të cilën nuk është dhënë amnisti

“Neni 121 (Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës)

1. Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që ta ndryshojë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës apo të përmbysë institucionet më të larta të Republikës së Kosovës, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

2. Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që të pengojë vendosjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës apo me përdorim të dhunës ose kanosjes së dhunës implementon rendin e huaj juridik në ndonjë pjesë të Republikës së Kosovës, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

3. Kushdo që me përdorim të dhunës ose me kanosje të dhunës tenton të rrezikojë pavarësinë e Kosovës, sovranitetin dhe integritetin e saj territorial, tërësinë territoriale dhe karakterin demokratik të shtetit, dënohet jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim”.

169. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.2 Kryengritja e armatosur (Neni 122)

“Neni 122 (Kryengritja e armatosur)

1. Kushdo që merr pjesë në kryengritje të armatosur, e cila është e drejtuar kundër rendit kushtetues, sigurisë apo integritetit territorial të Republikës së Kosovës, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

2. Organizatori i kryengritjes së armatosur nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim”.

170. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.3 Rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës (Neni 125)

“Neni 125 (Rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës)

“Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që ta shpëpusë një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës apo që ndonjë pjesë të territorit të saj t’ia bashkojë ndonjë shteti tjetër, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim”.

171. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.4 Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin ose dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike (Neni 129)

“Neni 129 (Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin ose dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike)

“Kushdo që me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo sigurisë së Republikës së Kosovës, djeg ose në çfarëdo mënyre tjetër shkatërron apo dëmton zonën industriale, bujqësore ose ndonjë zonë tjetër ekonomike, sistemin e trafikut, lidhjet e telekomunikimeve, pajisjet publike të ujit, ngrohjes, gazit apo energjisë, pendat, depot, apo ndonjë ndërtesë tjetër të rëndësishme për sigurinë, furnizimin e qytetarëve, ekonominë apo funksionimin e shërbimeve publike, dënohet me jo më pak se tre (3) vjet burgim”.

172. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.5 Spiunazhi (Neni 131)

“Neni 131 (Spiunazhi)

1. Kushdo që sekretin shtetëror ia komunikon, ia dorëzon apo ia bën të arritshëm shtetit të huaj, organizatës së huaj apo personit që u shërben atyre, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet burgim.

2. Kushdo që për shtetin apo organizatën e huaj krijon shërbimin informativ në Republikën e Kosovës apo drejton shërbimin e tillë, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

3. Kushdo që hyn në shërbimin informativ të huaj, mbledh të dhëna për të apo në ndonjë mënyrë tjetër e ndihmon punën e shërbimit të tillë, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

4. Kushdo që mbledh të dhëna apo dokumente të klasifikuara me qëllim që t'ia komunikojë dhe dorëzojë shtetit të huaj, organizatës së huaj apo personit që u shërben atyre, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

5. Nëse kryerja e veprës penale nga paragrafët 1., 2., 3. ose 4. të këtij neni ka shkaktuar pasoja të rënda për sigurinë ose fuqinë ekonomike apo ushtarake të shtetit, kryesi dënohet me burgim jo më pak se dhjetë (10) vjet.

6. Nëse vepra penale e saktësuar në paragrafin 1., 2., 3. ose 4. të këtij neni kryhet gjatë kohës së luftës, rrezikut të pashmangshëm për luftë, konfliktit të armatosur apo zbulimi i sekretit shtetëror ka të bëjë me sigurinë e Republikës së Kosovës, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

7. Për qëllime të këtij kapitulli, ‘sekret shtetëror’ nënkupton të dhënat apo dokumentet ushtarake, ekonomike apo zyrtare të cilat janë shpallur si informata të klasifikuara me ligj apo me dispozita ose vendime tjera të organit kompetent të nxjerra në pajtim me ligjin”.

173. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.6 Bashkimi për veprimtari kundërkushtetuese (Neni 134)

“Neni 134 (Bashkimi për veprimtari kundërkushtetuese)

1. Kushdo që formon një grup apo ndonjë bashkim tjetër të personave për kryerjen e veprave penale nga nenet 121-134 të këtij kodi, dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër penale.

2. Kushdo që merr pjesë apo bëhet anëtar i grupit apo bashkimit nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

3. Anëtari i grupit apo bashkimit, që e lajmëron grupin para kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet ose mund të lirohet nga dënimi”.

174. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.7 Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare (Neni 146, paragrafët 1, 2, 3.1 dhe 3.3)

“Neni 146, paragrafët 1, 2, 3.1 dhe 3.3 (Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare)

1. Kushdo që kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës në cilindo vend përveç në kufirin apo vendkalimet e autorizuara kufitare, dënohet me dyqind e pesëdhjetë (250) euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili është i shoqëruar nga një fëmijë ose ndonjë person tjetër, kryesi dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) euro ose me burgim deri në një (1) vit.

3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet nëse:

3.1. kryesi ka qenë më parë i dënuar për vepër penale nga ky nen;

3.3. kalimi është bërë ndërmjet orës tetë (8:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes gjatë periudhës prej 1 prillit deri më 30 shtator, ose ndërmjet orës gjashtë (6:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes gjatë periudhës prej 1 tetorit deri më 31 mars”.

175. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.8 Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik (Neni 147)

“Neni 147 (Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik)

1. *Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikës e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*
2. *Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*
3. *Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*
4. *Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet”.*

176. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.9 Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike (Neni 262, paragrafi 1)

“Neni 262, paragrafit 1 (Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike)

“1. Kushdo që pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizimet ligjore, kryen trajtime mjekësore, shërbime farmaceutike ose angazhohet në aktivitete tjera mjekësore për të cilat me ligj kërkohen kualifikime të posaçme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”.

177. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.10 Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë (Neni 333, paragrafi 1);

“Neni 333, paragrafit 1 (Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë)

1. Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 334 të këtij kodi, dënohet me burgim deri në një (1) vit”.

178. Në këtë rast Gjykata i referohet Nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës e cila thekson, si vijon:

“ ...

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*

2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*

3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.*

4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

...”

179. Për më tepër, Neni 1 (Mbrojtja e pronës), i Protokollit 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Lirive Themelore përcakton: “*Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të papengueshëm të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera*”.

180. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se prona është një e drejtë themelore e garantuar edhe me Kushtetutë, edhe me KEDNJ, si dhe me instrumente të tjera ndërkombëtare dhe se personat fizikë dhe juridikë nuk mund të privohen nga prona e tyre në mënyrë arbitrare dhe pa një arsyetim të drejtë.

181. Formulimi i nenit në fjalë tregon qartë se vepra e amnistuar penale ka të bëjë me pronën e tjetrit. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se viktimat e veprës së amnistuar penale do të privohen nga qasja në gjykatë për t’i mbrojtur të drejtat e tyre themelore të njeriut siç njihen me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

182. Sa i përket të drejtës për mjet juridik, përfshirë reparacionin, Gjykata vëren se nga shtetet, në përgjithësi, kërkohet t’u ofrojnë mjete juridike efektive viktimave të shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut dhe të shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare, përfshirë reparacionin. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se çdo shkelje e të drejtave të njeriut sjell për viktimën ose për përfituesit e tij/saj

të drejtën për reparacion, që nënkupton obligimin e shtetit për të ofruar reparacion dhe mundësi që të kërkohet kompensim nga kryesi.

183. Për më tepër, Gjykata vëren se e drejta për reparacion duhet të mbulojë të gjitha dëmet e shkaktuara viktimës; duhet të mbulojë masat e restitucionit, kompensimit, rehabilitimit dhe dëmshpërblimit.
184. Përveç kësaj, Gjykata nuk sheh se si do të korrespondonte kjo vepër e amnistuar penale me qëllimin e Ligjit për Amnisti, siç është paraqitur më lart në analizën e kontekstit socio-politik.
185. Kjo vepër penale, e propozuar për amnisti, qartazi paraqet kufizim të së drejtës për pronë dhe për qasje në drejtësi. Prandaj, Gjykata vëren se kjo vepër e amnistuar penale është në pajtueshmëri me nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së, por gjithashtu edhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

1.1.11 Zjarrvënia (Neni 334, paragrafi 1)

“Neni 334, paragrafi 1 (Zjarrvënia)

1. Kushdo që ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit të pasurisë së personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet”.

186. Kjo vepër e amnistuar penale gjithashtu saktëson se ka të bëjë me dëmtimin e pasurisë së një personi tjetër. Prandaj, Gjykata nuk sheh se si korrespondon kjo vepër e amnistuar penale me objektivat e Ligjit për Amnisti.
187. Kjo vepër penale, e propozuar për amnisti, qartazi paraqet kufizim të së drejtës për pronë dhe të qasjes në drejtësi. Prandaj, Gjykata konkludon se kjo vepër e amnistuar penale nuk është në pajtueshmëri me nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së, por gjithashtu me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

1.1.12 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve (Neni 374)

“Neni 374 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve)

1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

3. Arma në pronësi, kontroll apo posedim në shkelje të këtij neni konfiskohet”.

188. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.13 Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të veprave (neni 386, vetëm ndërlidhur me moslajmërimin e veprave penale për të cilat jepet amnisti me këtë nen [versionet shqip dhe serbisht qartazi tregojnë se kjo dispozitë vlen vetëm për moslajmërimin e veprave penale që amnistohen sipas këtij neni])

“Neni 386 (Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre)

1. Kushdo që është në dijeni për identitetin e kryesit të një apo më shumë prej veprave penale në vijim dhe nuk e lajmëron faktin e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet:

1.1. vrasja e rëndë;

1.2. vrasja;

1.3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;

1.4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;

1.5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;

1.6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;

1.7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;

1.8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve;

1.9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXX – Veprat penale të armëve;

2. Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nuk e lajmëron veprën penale të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse vepra e tillë është e dënueshme me së paku tre (3) vjet burgim.

3. Me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore”.

189. Gjykata vëren se ky nen i amnistion personat për moslajmërim të veprës penale lidhur me veprat penale për të cilat jepet amnisti me Ligjin për Amnisti. Kjo tregon se moslajmërimi i veprave më të rënda, të paraqitura në nenin 386, nuk

amnistohet (Shih nenin 386 (1) 1.1), vrasje (Shih nenin 386 (1) 1.2), sulm me lëndim të rëndë trupor (Shih nenin 386 (1) 1.3) dhe ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare (Shih nenin 386 (1) 1.5).

190. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.14. Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 388, vetëm ndërlidhur me dhënien e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale për të cilat jepet amnisti me këtë nen [versionet shqip dhe serbisht qartazi tregojnë se kjo dispozitë vlen vetëm për dhënie të ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale që amnistohen sipas këtij neni])

“Neni 388 (Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale)

1. Kushdo që strehon kryesin e ndonjë veprave penale, përveç veprave penale të parapara në paragrafin 2. të këtij neni, ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit ose arrestimit përmes fshehjes së mjeteve, provave apo në ndonjë mënyrë tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e arrestimit, ekzekutimit të dënimit apo urdhrit për trajtim të detyrueshëm, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me një apo më shumë prej veprave penale në vijim, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:

2.1. vrasja e rëndë;

2.2. vrasja;

2.3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;

2.4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;

2.5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;

2.6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;

2.7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIV – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;

2.8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve;

2.9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXX – Veprat penale të armëve;

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me vepër penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

4. Dënimi i paraparë me paragrafin 1. të këtij neni nuk mund të jetë më i ashpër, as sipas llojit e as sipas lartësisë, se dënimi i përcaktuar për veprën penale të kryer nga personi të cilit i jepet ndihma.

5. Me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore”.

191. Gjykata vëren se ky nen, ngjashëm sikurse edhe ai paraprak, amnistion personat për dhënien e ndihmës kryesve të veprave penale për të cilat jepet amnisti sipas Ligjit për Amnisti. Kjo tregon se dhënia e ndihmës kryesve të veprave më të rënda të paraqitura në nenin 388 nuk amnistohet (Shih nenin 388 (2) 2.1), vrasje (Shih nenin 388 (2) 2.2), sulm me lëndim të rëndë trupor (Shih nenin 388 (2) 2.3) dhe ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare (Shih nenin 388 (2) 2.5).
192. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15. Thirrja për rezistencë (Neni 411), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, për të cilën nuk është dhënë amnistia sipas këtij ligji. Kryesve të veprave penale në vijim, të kryera me qëllim të kryerjes së veprës penale të thirrjes për rezistencë, gjithashtu u është dhënë amnistia nga ndjekja apo ekzekutimi i dënimit

“Neni 411 (Thirrja për rezistencë)

1. Kushdo që thërret të tjerët për rezistencë apo mosbindje ndaj vendimeve apo masave të ligjshme të nxjerra nga organi apo zyrtari kompetent, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vështirësi të mëdha apo pamundësi të zbatimit të vendimit, masës apo veprimit zyrtar të ligjshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.

193. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.1 Kanosja e kandidatit (Neni 211)

“Neni 211 (Kanosja e kandidatit)

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme detyron ndonjë kandidat që të tërheq kandidaturën e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

2. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon ose pengon ndonjë kandidat nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie gjatë fushatës elektorale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

3. Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet”.

194. Gjykata konsideron se kjo veprë e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.2 Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar (Neni 212)

“Neni 212 (Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar)

1. Kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave të besuara lidhur me zgjedhjet, në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të votuar, nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose e heq personin e tillë nga lista e regjistrimit të votuesve, dënohet me burgim prej një (1) viti deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që gjatë votimit ose referendumit, në mënyrë të kundërligjshme parandalon, pengon ose ndikon në përcaktimin e lirë të votuesit ose në ndonjë mënyrë tjetër pengon personin tjetër në ushtrimin e së drejtës së tij për të votuar, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

3. Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafët 1. dhe 2. i këtij neni me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, dënohet me burgim prej një (1) vjet deri në pesë (5) vjet”.

195. Gjykata konsideron se kjo veprë e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.3 Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (Neni 290, nënparagrafët: 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të paragrafit 1)

“Neni 290 (Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike)

1. Personi përgjegjës që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kryen një nga veprimet në vijim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të

dobisë pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:

1.1. krijon apo mban fonde të palejuara në Republikën e Kosovës ose në ndonjë juridiksion tjetër;

1.2. përmes përpilimit të dokumenteve me përmbajtje të rreme, me bilance të rreme, me vlerësime të rreme, inventarizim apo me prezantim tjetër të rremë ose përmes fshehjes së provave në mënyrë të rreme e prezanton qarkullimin e aseteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit gjatë vendimmarrjes lidhur me veprimtaritë menaxhuese;

1.3. nuk i paguan detyrimet tatimore ose detyrimet e tjera fiskale të parapara me ligj;

1.4. mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë”.

196. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.4 Tregtia e ndaluar (Neni 305)

“Neni 305 (Tregtia e ndaluar)

1. Kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallrave sendeve apo shërbimeve, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kur kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka organizuar rrjetin e shitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

3. Mallrat dhe sendet nga tregtia e ndaluar konfiskohen”.

197. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.5 Shmangia nga tatimi (Neni 313)

“Neni 313 (Shmangia nga tatimi)

1. Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo

fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kur detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

3. Kur detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumën prej pesëdhjetëmijë (50.000) euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”.

198. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.6 Kontrabandimi i mallrave (Neni 317, paragrafi 1 dhe paragrafi 2)

“Neni 317 (Kontrabandimi i mallrave)

1. Kushdo që duke kaluar vijën kufitare bart mallra dhe shmang kontrollin doganor, ose kushdo që duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallrave dhe kalon vijën kufitare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që pa leje përkatëse, shmang kontrollin doganor dhe kalon vijën kufitare duke bartur mallrat, eksportimi apo importimi i të cilave është i ndaluar, i kufizuar apo kërkon leje të posaçme nga organi kompetent, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.

199. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.7 Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore (Neni 318)

“Neni 318 (Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore)

1. Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vlera e pagesës së shmangur nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse vlera e pagesës së shmangur nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon tridhjetëmijë (30.000) euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4. Mallrat të cilat nuk janë deklaruar saktë apo vlera e pagesës së shmangur, cilado që të jetë më e lartë, konfiskohen”.

200. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.8 Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike (Neni 366, paragrafi 1 dhe paragrafi 2)

“Neni 366 (Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike)

1. Kushdo që asgjëson, dëmton apo i heq pajisjet apo instalimet e përçuesve elektrik, të gazit, të ujit, të ngrohjes, të pajisjeve telekomunikuese, të pajisjeve të kanalizimit, të pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit, naftësjellësve, kabllave nënujore, të pendave ose të pajisjeve të tjera të ngjashme dhe me këtë shkakton çrregullime në furnizimin e popullsisë apo të ekonomisë, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”.

201. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.9 Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo me mjete të rrezikshme (Neni 380, paragrafët: 1, 2 dhe 5)

“Neni 380 (Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo me mjete të rrezikshme)

1. Kushdo që asgjëson, heq ose dëmton rëndë instalimet, pajisjet, shenjat apo sinjalizimet që shërbejnë për sigurinë e trafikut, ose jep shenja ose sinjale të gabueshme ose vë pengesa në rrugët publike apo në ndonjë mënyrë tjetër e rrezikon jetën e njeriut apo sigurinë fizike, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm të konsiderueshëm pasuror, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”.

202. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.10 Falsifikimi i dokumenteve (Neni 398)

“Neni 398 (Falsifikimi i dokumenteve)

1. Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.

203. Sa i përket kësaj vepre të amnistuar penale, Gjykata konsideron se është e vështirë të shihet se si mund të hyjë ajo brenda sferës së objektivave të Ligjit. Siç u përmend më lart, vepra e amnistuar penale duhet të ketë lidhje me objektivat e amnistisë, pra t'i japë fund konfliktit ose të promovojë pajtimin ndërmjet palëve të përfshira, duke qenë pjesë e marrëveshjes për paqe. Amnistimi i kryesve, siç është paraparë me këtë nen, nuk i plotëson këto kërkesa.

204. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet, ndër të tjera, në parimin e sundimit të ligjit, që nënkupton edhe aspektin e sigurisë juridike. Siguria juridike duhet të garantojë stabilitetin e një sistemi juridik, që do të thotë se individët duhet të gëzojnë garancitë që ofron sistemi juridik në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

205. Gjykata konsideron se, në një sistem të sundimit të ligjit, personat fizikë dhe juridikë duhet të jenë në gjendje të mbështeten në dokumente publike, siç janë dokumentet për të drejtat pronësore, dhe të kontestojnë vërtetësinë e një dokumenti që do të kufizonte të drejtat e tyre. Ndryshe, parimi i sigurisë juridike do të minohej, pasi individët më nuk do të mund të ishin të sigurt se dokumentet e tilla nuk janë falsifikuar.

206. Kështu, viktimat e veprave të tilla penale do të pengoheshin të kenë qasje në drejtësi, sepse ata do të duhej të provonin në procedurë civile se dokumentet nuk janë të vërteta, ndërsa gjyqtari do të duhej të merrte parasysh se kryesi dhe vepra penale kanë përfituar nga amnistia.

207. Për më tepër, kryesit e veprave penale të cilët hyjnë në fushëveprimin e këtij neni, kanë për detyrë të paraqesin produktet e veprës penale. Nëse nuk e bëjnë këtë, kjo do të rrezikonte parimet e lartpërmendura dhe do të dëmtonte Kosovën si shtet i sundimit të ligjit.

208. Prandaj, Gjykata konkludon se kjo vepër e amnistuar penale nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me parimet e mishëruara aty.

1.1.15.11 Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve (Neni 399, nënparagrafi 1.1 dhe nënparagrafi 1.4, të paragrafit 1)

“Neni 399 (Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve)

1. Personi do të konsiderohet se ka kryer vepër penale të falsifikimit të dokumenteve dhe do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë:

1.1. pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë formë tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike;

1.4. lëshon një dokument dhe pohon me nënshkrimin e vet se ka ndonjë pozitë, thirrje apo gradë edhe pse nuk ka pozitë, thirrje apo gradë të tillë, ndërsa veprimi i tillë ka ndikim substancial në vlerën e dokumentit”...

209. Gjykata konsideron se arsyetimi i njëjtë, sikurse në veprën e lartpërmendur penale nga neni 398 të Kodit Penal, vlen edhe për këtë vepër të amnistuar penale.

210. Gjykata, rrjedhimisht, konkludon se kjo vepër e amnistuar penale nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe me parimet e mishëruara aty.

1.1.15.12 Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (Neni 409, paragrafët: 1, 2 dhe 3)

“Neni 409 (Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare)

1. Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

3. Udhëheqësi apo organizatori i grupit që kryen vepër penale nga paragrafi 2. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet”.

211. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e

qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.13 Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (Neni 410, paragrafi 1), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me vdekje

“Neni 410 (Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare)

1. Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, gjyqtarin, prokurorin apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”.

212. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.14 Dispozitat penale sipas Ligjit për Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si në vijim:

1.1.15.14.1 Pengimi i lëvizjes së automjeteve të Doganës (Neni 296)

“Neni 296 (Pengimi i lëvizjes së automjeteve të Doganës)

Kush, përveç me arsye dhe me qëllim të mirë, pengon në çfarëdo mënyre në ndonjë automjet, mjet lundrues apo mjet ajror, që përdoret nga oficerët doganor gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

213. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.14.2 Dhënia e deklaratës së pavërtetë (Neni 297)

“Neni 297 (Dhënia e deklaratës së pavërtetë)

(1) Kush bën, nënshkruan, apo ndikon në bërjen apo në nënshkrimin, apo dorëzon apo ndikon që një oficeri doganor t'i dorëzohet çfarëdo deklaratë, shënimi, certifikate apo ndonjë dokument tjetër i cili është i pavërtetë në çfarëdo të dhënë materiale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

(2) Kush, jep çfarëdo deklaratë si përgjigje ndaj çfarëdo pyetjeje të shtruar nga ana e zyrtarit doganor, e që paraqet një deklaratë të bërë për qëllime doganore, e cila është e pavërtetë në çfarëdo të dhënë materiale, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit”.

214. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.14.3 Shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza (Neni 298)

“Neni 298 (Shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza)

(1) Kush në çfarëdo mënyre është i përfshirë në shmangie mashtruese nga taksa e importit apo akciza që i nënshtrohen mallrat, dënohet:

1) me gjobë dhe me burgim prej tre muaj deri në tri vjet atëherë kur shuma e detyrimeve të shmangura nga taksa e importit apo akciza nuk e kalon 15.000 € dhe

2) me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet atëherë kur shuma e detyrimeve të shmangura nga taksa e importit apo akciza e kalon 15.000 €.

(2) Çdo tentativë për të kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij nenit gjithashtu është e dënueshme”.

215. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.14.4 Shmangiet mashtruese nga zbatimi i ndalesave dhe kufizimeve mbi mallra (Neni 299)

“Neni 299 (Shmangiet mashtruese nga zbatimi i ndalesave dhe kufizimeve mbi mallra)

(1) Kush në çfarëdo mënyre është i përfshirë në shmangie mashtruese nga zbatimi i ndonjë ndalese apo kufizimi për importimin e mallit që është në fuqi, dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet.

(2) Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij nenit gjithashtu është e dënueshme”.

216. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.15.14.5 Veprat penale në lidhje me produktet me akcizë (Neni 300)

“Neni 300 (Veprat penale në lidhje me produktet me akcizë)

(1) Kush në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në lidhje me akcizën dhe taksën doganore, shet, ofron për shitje, ekspozon apo përndryshe merret me produkte të pashenjë (pa pullë), dënohet me gjobë deri në pesë herë të shumës së akcizës të paevidentuar apo të papapaguar, nëse shuma e akcizës nuk kalon shumën prej 25.000 € dhe me burgim deri në shtatë vjet, nëse shuma e paevidentuar apo e papaguar tejkalon shumën 25.000 €.

(2) Me dënim nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet edhe kush në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në lidhje me akcizën dhe taksën doganore, posedon, importon, eksporton apo transporton produkte pa-shenjë.

(3) Kush lejon objektet të cilat janë nën kontrollin apo posedimin e tij apo të saj të shfrytëzohen për shitje, apo për punë të tjera, që lidhen me mallrat pa-shenjë, dënohet me gjobë prej më të paktën 5.000 euro apo dënim me burgim deri në tri vjet”.

217. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.1.16 Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi (Neni 412), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje

“Neni 412 (Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi)

1. Kushdo që merr pjesë në turmën e mbledhur prej më tepër se tetë personave, e cila me veprime të përbashkëta e privon personin tjetër nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, shkakton dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) euro apo më shumë ose kryen vepra tjera të rënda të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim apo tenton të kryejë vepra të tilla, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Organizatori i turmës nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet”.

218. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Veprat penale të parapara me Kodin Penal të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25, e 6 korrikut 2003, Gazeta Zyrtare 2003/25) si dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/19 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, si në vijim:

219. Neni 353 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës përcakton: “Të gjitha sanksionet penale për veprat të cilat edhe me këtë kod janë të ndëshkueshme dhe të shqiptuara me aktgjykim të formës së prerë para hyrjes në fuqi të këtij kodi vazhdojnë me kohëzgjatje dhe lartësi të njëjtë”.
220. Për më tepër, neni 354 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës përcakton: “(1) Dispozitat në Rregulloret e UNMIK-ut që mbulojnë çështjet e trajtuara në këtë kod pushojnë të jenë në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij kodi pos nëse shprehimisht nuk është paraparë ndryshe me këtë kod ose me Rregulloret të UNMIK-ut. (2) Dispozitat e Kodeve Penale në fuqi pushojnë të kenë fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij kodi”.

1.2.1 Sulmi kundër rendit kushtetues të Kosovës (Neni 108)

“Neni 108 (Sulmi kundër rendit juridik të Kosovës)

Kushdo që tenton të ndryshojë rendin juridik të vendosur në Kosovë me anë të përdorimit të dhunës ose të kanosjes në fushën legislative, ekzekutive a gjyqësore ose për të përmbysur një organ publik, dënohet me burgim së paku pesë vjet”.

221. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.2 Kalimi i paaautorizuar i vendkalimeve kufitare apo vijës kufitare (Neni 114, paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3.1, paragrafi 3.3, si dhe paragrafi 4)

“Neni 114 (Kalimi i paaautorizuar i vendkalimeve kufitare apo vijës kufitare)

(1) Kushdo që kalon kufirin shtetëror ose atë administrativ të Kosovës në cilindo vend përveç në vendkalimet e autorizuara kufitare dënohet me gjobë prej 250 euro ose me burgim prej tre muajsh.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryesi i shoqëruar me një fëmijë ose me ndonjë person tjetër, kryesi dënohet me gjobë prej 2,500 euro ose me burgim deri në një vit.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në njërën apo në më shumë rrethana të mëposhtme kryesi dënohet me burgim deri në dy vjet nëse:

1) Kryesi ka qenë më parë i dënuar për vepër penale nga ky nen;

...

3) Kalimi është bërë ndërmjet orës 8:00 në mbrëmje dhe orës 6:00 në mëngjes gjatë periudhës prej 1 prillit deri më 30 shtator, ose ndërmjet orës 6:00 në mbrëmje deri në orën 6:00 në mëngjes gjatë periudhës prej 1 tetorit deri më 31 mars; ose

(4) Personi nuk përgjigjet penalisht sipas këtij neni për kalimin në një pikë kufitare të paautorizuar të kufirit shtetëror ose administrativ nëse kalimi ka ndodhur në një vendkalim i cili është hapur përkohësisht nga Komandanti i KFOR-it”.

222. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.3 Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik (Neni 115)

“Neni 115 (Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik)

(1) Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike a çfarëdo grupesh të tjera të tilla që jetojnë në Kosovë në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që në mënyrë sistematike kryen vepër nga paragrafi 1 i këtij neni ose keqpërdorur pozitën a autorizimet apo shkakton trazira, dhunë a pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë dënohet me burgim deri në tetë vjet.

(3) Kushdo që kryen vepër nga paragrafi 1 përmes detyrimit, rrezikimit të sigurisë duke i përqeshur simbolet kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(4) Kushdo që në mënyrë sistematike kryen vepër nga paragrafi 3 i këtij neni ose keqpërdor pozitën, autoritetin e tij apo shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet”.

223. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.4 Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore (Neni 221, paragrafi 1)

“Neni 221 (Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore)

(1) Kushdo që pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizime ligjore kryen trajtime mjekësore ose angazhohet në disa aktivitete të tjera mjekësore për të cilat ligji kërkon kualifikime të posaçme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit”.

224. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.5 Dëmtimi i pronës së luajtshme (Neni 260)

“Neni 260 (Dëmtimi i pronës së luajtshme)

(1) Kushdo që e dëmton, e asgjëson apo e bën të papërdorshme pasurinë e luajtshme të personit tjetër dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni motivohet nga paragjykimi lidhur me përkatësinë etnike apo nacionale, racore, fetare, të gjinisë, të orientimit seksual apo të gjuhës, kryesi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit”.

225. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, i cili thekson:

“...

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

...”

226. Për më tepër, neni 1 (Mbrojtja e pronës), i Protokollit 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Lirive Themelore, përcakton: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të papengueshëm të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të*

rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

227. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se prona është një e drejtë themelore, e garantuar edhe me Kushtetutë, edhe me KEDNJ, si dhe me instrumente të tjera ndërkombëtare, dhe se personat fizikë dhe juridikë nuk mund të privohen nga prona e tyre në mënyrë arbitrare dhe pa një arsyetim të drejtë.
228. Formulimi i nenit në fjalë tregon qartë se vepra e amnistuar penale ka të bëjë me pronën e tjetrit. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se viktimat e veprës së amnistuar penale do të privohen nga qasja në gjykatë për t'i mbrojtur të drejtat e tyre themelore të njeriut, siç njihen me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
229. Sa i përket të drejtës për mjet juridik, përfshirë reparacionin, Gjykata vëren se nga shtetet, në përgjithësi, kërkohet që t'u ofrojnë mjete juridike efektive viktimave të shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut dhe të shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare, përfshirë reparacionin. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se çdo shkelje e të drejtave të njeriut sjell për viktimën ose për përfituesit e tij/saj të drejtën për reparacion, që nënkupton obligimin e shtetit për të ofruar reparacion dhe mundësi që të kërkohet kompensim nga kryesi.
230. Për më tepër, Gjykata vëren se e drejta për reparacion duhet të mbulojë të gjitha dëmet e shkaktuara viktimës; duhet të mbulojë masat e restitucionit, të kompensimit, të rehabilitimit dhe të dëmshpërblimit.
231. Përveç kësaj, Gjykata nuk sheh se si do të korrespondonte kjo vepër e amnistuar penale me qëllimin e Ligjit për Amnisti, siç është paraqitur më lart në analizën e kontekstit socio-politik.
232. Kjo vepër penale, e propozuar për amnisti, qartazi paraqet kufizim të së drejtës për pronë dhe për qasje në drejtësi. Prandaj, Gjykata vëren se kjo vepër e amnistuar penale është në papajtueshmëri me nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së, por gjithashtu edhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

1.2.6 Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve (Neni 328, paragrafi 2), si dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të armëve pa leje valide për mbajtjen e autorizuar të armës (Neni 8.6, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/7, e 21 shkurtit 2001, Gazeta Zyrtare 2001/7)

“Neni 328 (Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve)

...

(2) Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet”.

“Neni 8 (Veprat penale dhe dënimet)

8.6

Çdo person që kryen veprë penale sipas neneve të mësipërme 8.2 dhe 8.4 i nënshtrohet dënimit me burg deri në kohëzgjatje jo më shumë se 8 vjet ose me të holla deri në 15.000 DM ose të dyja së bashku. Çdo lloj leje që i është lëshuar atij personi automatikisht i anulohet”.

233. Gjykata konsideron se kjo veprë e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.7 Mosraportimi i veprës penale ose kryesit të saj (Neni 303, vetëm sa i përket veprave penale për të cilat është dhënë amnistia sipas këtij ligji)

“Neni 303 (Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale)

(1) Kushdo që, duke qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së një veprë penale, e cila dënohet me së paku pesë vjet burgim nuk e lajmëron këtë fakt në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mundur të evitohet, ndërsa vepra penale është kryer ose është tentuar që të kryhet dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që nuk lajmëron përgatitjet për kryerjen e veprës penale, e cila dënohet me burgim afatgjatë dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(3) Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse ai është në lidhje me kryesin e veprës penale si bashkëshort, partner jashtëmartesor, i afërm i gjakut i shkallës së parë, vëlla ose motër, prind adoptues ose fëmijë i adoptuar, bashkëshort ose partner me të cilin bashkëjeton”.

234. Gjykata konsideron se kjo veprë e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.8 Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (Neni 305, vetëm sa i përket veprave të amnistuara penale sipas këtij ligji)

“Neni 305 (Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale)

(1) Kushdo që strehon kryesin e veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit të veprës përmes fshehjes së mjeteve, provave a në çfarëdo mënyre tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e ekzekutimit të dënimit a urdhrin për trajtim të detyrueshëm dënohet me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që ndihmon kryesin e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim mbi pesë vjet dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Kushdo që ndihmon kryesin e veprës penale të dënueshme me burgim afatgjatë dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(4) Dënimi për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë më i rëndë as sipas llojit e as sipas lartësisë së dënimit i përcaktuar për veprën penale të kryer nga personi të cilit i jepet ndihma.

(5) Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është në marrëdhënie me kryesin e veprës penale si bashkëshort, partner jashtëmartesor, i afërm i gjakut i shkallës së parë, vëlla ose motër, prind adoptues ose fëmijë i adoptuar, bashkëshort ose partner me të cilin bashkëjeton”.

235. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9 Thirrja për rezistencë (Neni 319), përveç në rastet kur kryerja e kësaj veprë penale ka rezultuar me kryerjen e një veprë tjetër penale për të cilën nuk është dhënë amnistia sipas këtij ligji. Kryesit e këtyre veprave penale, si më poshtë, të kryera me qëllimin e kryerjes së veprës penale të thirrjes për rezistencë, gjithashtu fitojnë amnisti nga ndjekja penale dhe nga ekzekutimi i ndëshkimit

“Neni 319 (Thirrja për rezistencë)

Kushdo që nxit të tjerët me përdorim të dhunës ose me kanosje serioze për të ndaluar ekzekutimin e vendimeve apo masave të ligjshme të lëshuara nga organi kompetent apo zyrtarët gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dënohet me jo më shumë se tri vjet burgim”.

236. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.1 Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (Neni 236, paragrafi 1, nënparagrafët: 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4)

“Neni 236 (Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi)

(1) Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit ose personin juridik në të cilin është i punësuar apo organizatën tjetër të

biznesit ose për personin juridik dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet nëse ai kryen ndonjërin prej veprave të mëposhtme:

1) Krijon apo mban fonde të palejuara në Kosovë ose në çfarëdo juridiksioni tjetër;

2) Me përpilimin e dokumenteve me përmbajtje të rrejshme, me bilance të rreme, me vlerësime apo inventarizim apo me prezentim tjetër të rremë a me fshehjen e fakteve në mënyrë të rreme e prezenton lëvizjen e mjeteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit apo në personin juridik gjatë vendimmarrjes lidhur me punët e qeverisjes;

3) Nuk i paguan mjetet nga detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera fiskale në Kosovë të përcaktuara me ligj;

4) Mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë”.

237. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.2 Tregtia e ndaluar (Neni 246)

“Neni 246 (Tregtia e ndaluar)

(1) Kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallit a të sendeve, qarkullimi i të cilave është i ndaluar apo i kufizuar, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(2) Nëse kryesi i veprës nga paragrafi 1 i këtij neni ka organizuar rrjetin e stërshitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë 15.000 euro dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Malli dhe sendet e tregtisë së ndaluar konfiskohen”.

238. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.3 Shmangia nga tatimi (Neni 249)

“Neni 249 (Shmangia nga tatimi)

(1) Kushdo i cili me qëllim që ai apo personi tjetër t'i shmanget pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera të

përcaktuara me ligj jep të dhëna të pavërteta për të ardhurat e veta apo nuk i përfshin informatat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të këtilla dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse shuma e detyrimit nga paragrafi 1 i këtij neni, pagimi i të cilit shmangët është më e lartë se 15.000 euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet”.

239. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.4 Kontrabandimi i mallrave (Neni 273)

“Neni 273 (Kontrabandimi i mallrave)

(1) Kushdo që pa autorizim ose pa leje bën tregti apo në ndonjë mënyrë tjetër bart mallrat brenda a jashtë territorit të Kosovës dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

(2) Mallrat e kontrabanduara konfiskohen”.

240. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.5 Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike (Neni 292, paragrafi 1 dhe paragrafi 2)

“Neni 292 (Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike)

(1) Kushdo që asgjëson, dëmton, i heq pajisjet apo instalimet e përçuesve elektrik, të gazit, të ujit, të ngrohjes, të pajisjeve telekomunikuese, të pajisjeve të kanalizimit, të pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit ose të naftës-jellësve, të kablllove nënujore, të pendave ose të pajisjeve të tjera të ngjashme duke shkaktuar çrregullime në furnizimin e popullsisë apo të ekonomisë dënohet me burgim deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit”.

241. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.6 Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme (Neni 299, paragrafi 1 dhe paragrafi 2)

“Neni 299 (Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme)

(1) Kushdo që asgjëson, heq ose dëmton rëndë instalimet, pajisjet, shenjat apo sinjalizimet që shërbejnë për sigurinë e trafikut, jep shenja ose sinjale të gabueshme, vë pengesa në rrugët publike apo në ndonjë mënyrë tjetër e rrezikon trafikun dhe kështu vë në rrezik jetën e njeriut, sigurinë fizike apo pasurinë në përmasa të mëdha dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me burgim deri në një vit”.

242. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.7 Falsifikimi i dokumenteve zyrtare (Neni 348)

“Neni 348 (Falsifikimi i dokumenteve zyrtare)

(1) Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili në dokumentin zyrtar ose afarist, në regjistër zyrtar ose në shkresë shënon informacion të rremë ose nuk shënon informacionin thelbor apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar a afarist, vërteton regjistrin zyrtar ose shkresën e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(2) Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili shfrytëzon dokumentin e rremë zyrtar apo afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën sikur të ishin të vërteta në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në çfarëdo mënyre tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar ose afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni”.

243. Sa i përket kësaj veprë të amnistuar penale, Gjykata konsideron se është e vështirë të shihet se si mund të hyjë ajo brenda sferës së objektivave të Ligjit. Siç u përmend më lart, vepra e amnistuar penale duhet të ketë lidhje me objektivat e amnistisë, pra t'i japë fund konfliktit ose të promovojë pajtimin ndërmjet palëve të përfshira, duke qenë pjesë e marrëveshjes për paqe. Amnistimi i kryesve, siç është paraparë me këtë nen, nuk i plotëson këto kërkesa.

244. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet, ndër të tjera, në parimin e sundimit të ligjit, që nënkupton edhe aspektin e sigurisë juridike. Siguria juridike duhet të garantojë stabilitetin e një sistemi juridik, që do të thotë se individët duhet të gëzojnë garancitë që ofron sistemi juridik në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

245. Gjykata konsideron se, në një sistem të sundimit të ligjit, personat fizikë dhe juridikë duhet të jenë në gjendje të mbështeten në dokumente publike, siç janë dokumentet për të drejtat pronësore, dhe të kontestojnë vërtetësinë e një dokumenti që do të kufizonte të drejtat e tyre. Ndryshe, parimi i sigurisë juridike do të minohej, pasi që individët më nuk do të mund të ishin të sigurt se dokumentet e tilla nuk janë falsifikuar.
246. Kështu, viktimat e veprave të tilla penale do të pengoheshin të kenë qasje në drejtësi, sepse ata do të duhej të provonin në procedurë civile se dokumentet nuk janë të vërteta, ndërsa gjyqtari do të duhej të merrte parasysh se vepra penale është amnistuar.
247. Për më tepër, kryesit e veprave penale, të cilët bien në fushëveprimin e këtij neni, kanë për detyrë të paraqesin produktet e veprës penale. Nëse jo, kjo do të rrezikonte parimet e lartpërmendura dhe do të dëmtonte Kosovën si shtet i sundimit të ligjit.
248. Prandaj, Gjykata konkludon se kjo vepër e amnistuar penale nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me parimet e mishëruara aty.

1.2.9.8 Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Neni 316)

“Neni 316 (Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare)

(1) Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të atëçastshëm të dhunës, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimtarinë e kompetencave të tij ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin fyerjen ose keqpërdorimin e personit zyrtar apo kanosjen për përdorimin e armës ose rezulton me lëndim të lehtë trupor, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tri vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik, burgosjes së kryesit të veprës penale apo të ruajtjes së personit të privuar nga liria, kryesi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(4) Tentativa për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni dënohet.

(5) Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1 deri te paragrafi 3 i këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal i personit zyrtar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi”.

249. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e

gasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.9.9 Sulmi ndaj personave zyrtarë në kryerje të detyrave zyrtare (Neni 317), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndime të rënda trupore apo me vdekje

“Neni 317 (Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare)

(1) Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar ose personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo të ndihmësit të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës kryesi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të personit zyrtar ose të ndihmësit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(4) Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal i personit zyrtar ose i ndihmësit të tij, gjykata mund ta lirojë nga dënimi”.

250. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e gasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.2.10 Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale (Neni 320), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar në lëndime të rënda trupore apo me vdekje

“Neni 320 (Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale)

(1) Kushdo që merr pjesë në një turmë të mbledhur, e cila me veprime kolektive e privon personin nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, dëmton pasurinë në përmasa të mëdha ose kryen vepra të tjera të shkeljeve të rënda apo tenton të kryejë vepra të tilla dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(2) Organizuesi i turmës të cekur në paragrafin 1 të këtij neni dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet”.

251. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e

gasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3 Veprat penale të parapara me Ligjin Penal të KSAK, Gazeta Zyrtare nr. 20/77, si dhe me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 e nr. 2000/59 për Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, si në vijim:

1.3.1 Dëmtimi i sendit të një personi tjetër (Neni 145)

“Neni 145 (Dëmtimi i sendit të një personi tjetër)

(1) Kushdo që dëmton, shkatërron ose e bën të padobishëm sendin e një personi tjetër gjobitet apo dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse dëmi i tillë tejkalon shumën prej 30,000 dinarësh, kryesi dënohet me gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim.

(3) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj pronës private, procedurat ndërmerren me padi private”.

252. Në këtë rast Gjykata i referohet nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, i cili thekson, si vijon:

“...

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

...”

253. Për më tepër, neni 1 (Mbrojtja e pronës), i Protokollit 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Lirive Themelore, përcakton: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të papengueshëm të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të*

drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

254. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se prona është një e drejtë themelore, e garantuar edhe me Kushtetutë, edhe me KEDNJ, si dhe me instrumente të tjera ndërkombëtare, dhe se personat fizikë dhe juridikë nuk mund të privohen nga prona e tyre në mënyrë arbitrare dhe pa një arsyetim të drejtë.
255. Formulimi i nenit në fjalë tregon qartë se vepra e amnistuar penale ka të bëjë me pronën e tjetrit. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se viktimat e veprës së amnistuar penale do të privohen nga qasja në gjykatë për t'i mbrojtur të drejtat e tyre themelore të njeriut, siç njihen me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
256. Sa i përket të drejtës për mjet juridik, përfshirë reparacionin, Gjykata vëren se nga shtetet, në përgjithësi, kërkohet t'u ofrojnë mjete juridike efektive viktimave të shkeljeve të mëdha të të drejtave të njeriut dhe të shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare, përfshirë reparacionin. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se çdo shkelje e të drejtave të njeriut sjell për viktimën ose për përfituesit e tij/saj të drejtën për reparacion, që nënkupton obligimin e shtetit për të ofruar reparacion dhe mundësi që të kërkohet kompensim nga kryesi.
257. Për më tepër, Gjykata vëren se e drejta për reparacion duhet të mbulojë të gjitha dëmet shkaktuar viktimës; duhet të mbulojë masat e restitucionit, të kompensimit, të rehabilitimit dhe të dëmshpërblimit.
258. Përveç kësaj, Gjykata nuk sheh se si do të korrespondonte kjo vepër e amnistuar penale me qëllimin e Ligjit për Amnisti, siç është paraqitur më lart në analizën e kontekstit socio-politik.
259. Kjo vepër penale, e propozuar për amnisti, qartazi paraqet kufizim të së drejtës për pronë dhe për qasje në drejtësi. Prandaj, Gjykata vëren se kjo vepër e amnistuar penale është në papajtueshmëri me nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 1, të Protokollit 1, të KEDNJ, por gjithashtu edhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

1.3.2 Posedimi i paligjshëm i armëve apo i substancave eksplozive (Neni 199, paragrafi 1)

“Neni 199 (Posedimi i paligjshëm i armëve apo i substancave eksplozive)

(1) Kushdo që pa autorizim prodhon, shet, siguron apo shkëmben armë zjarri, municione apo substanca eksplozive apo që pa autorizim posedon armë zjarri, municione apo substanca eksplozive sigurimi i të cilave është i ndaluar për qytetarët, do të dënohet me deri në tri vjet burgim”.

260. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.3 Mosraportimi i veprave penale apo kryesit (Neni 173, vetëm në lidhje me veprat e amnistuara penale nga ky ligj)

“Neni 173 (Mosraportimi i veprave penale apo kryesve)

(1) Kushdo që e njeh kryesin e një vepre penale të dënueshme apo që është në dijeni se një vepër e tillë është kryer por nuk e raporton atë përkundër se identifikimi në kohë i kryesit të një vepre penale varet nga raportimet e tilla do të dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Një person zyrtar apo person përgjegjës i cili me vetëdije nuk raporton një vepër penale për të cilën ai është vënë në dijeni gjatë zbatimit të detyrës së tij, nëse ajo vepër është e dënueshme me pesë vjet burgim apo një dënim më të rëndë dhe nëse kjo vepër ndiqet penalisht sipas detyrës zyrtare, ai do të dënohet me dënimin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

(3) Për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni, personat në vijim nuk do të dënohen: bashkëshortja e kryesit, personi me të cilin kryesi jeton në martesë sipas ligjit, të afërmit e drejtpërdrejtë të gjakut, vëllai apo motra, adoptuesi apo i adoptuari apo avokati mbrojtës i kryesit, mjeku apo rrëfyesi. Nëse cilido prej personave të referuar në këtë paragraf, përpos avokatit mbrojtës, mjekut apo rrëfyesit të kryesit nuk do të dënohen për mosraportimin e një vepre penale të kryesit nga paragrafi 1 i këtij neni, atëherë as bashkëshortja apo personi me të cilin ai jeton në martesë sipas ligjit nuk do të dënohen”.

261. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.4. Ndhimja për kryesin pasi që ai ka kryer një vepër penale (Neni 174, vetëm në lidhje me veprat penale të amnistuara nga ky ligj)

“Neni 174 (Ndhimja për kryesin e veprës penale pasi që ai ka kryer një vepër penale)

(1) Kushdo që strehon një kryes të një vepre penale i cili është i ndjekur penalisht sipas detyrës zyrtare ose duke i fshehur mjetet, gjurmët, objektet apo në çfarëdo mënyre tjetër e ndihmon atë për të mos u kapur apo cilido person që strehon një person të dënuar apo ndërmerr veprime tjera me qëllim të parandalimit të zbatimit të dënimit të shqiptuar, masës së sigurisë apo masave korrektuese apo dërgimit në një objekt edukativ apo në një institucion edukativ-korrektues do të dënohet deri me një vit burgim.

(2) Kushdo që e ndihmon një kryes të një vepre penale për të cilën parashihet dënim me mbi pesë vjet burgim do të dënohet me tre muaj deri në tri vjet burgim.

(3) Kushdo që e ndihmon kryesin e një vepre penale për të cilën parashihet dënimi me vdekje do të dënohet me dhjetë vjet burgim.

(4) Dënimi për veprën nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë i natyrës më të ashpër për nga lloji apo kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar për veprën penale të kryer nga personi të cilit i është ndihmuar.

(5) Për veprën penale nga paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni, personat në vijim nuk do të dënohen: bashkëshortja e kryesit, personi me të cilin kryesi jeton në martesë sipas ligjit, të afërmit e drejtpërdrejtë të gjakut, vëllai apo motra, adoptuesi apo i adoptuari. Nëse cilido prej personave të referuar në këtë paragraf, nuk do të dënohen për veprat penale nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni, atëherë as bashkëshortja apo personi me të cilin ai jeton në martesë sipas ligjit nuk do të dënohen për ndihmën kryesit të një vepre penale nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni”.

262. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5 Nxitja e rezistencës (Neni 186), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me kryerjen e një vepre tjetër e cila nuk është e amnistuar, në lidhje me veprat e mëposhtme penale të kryera, me qëllim të kryerjes së veprës penale të thirrjes për rezistencë, gjithashtu amnistohen nga ndjekja penale dhe ekzekutimi i dënimit

“Neni 186 (Nxitja e rezistencës)

(1) Kushdo që nxit të tjerët në rezistencë apo mosbindje për të ndaluar ekzekutimin e vendimeve apo masave të ligjshme të lëshuara nga organi kompetent apo zyrtarët gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dënohet me jo më shumë se tri vjet burgim.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton në dështimin e ekzekutimit të vendimeve apo masave të ligjshme të lëshuara nga organi kompetent apo në vështirësi të theksuara gjatë zbatimit të tij apo nëse vepra kryhet nga udhëheqësi i një grupi, kryesi do të dënohet me një deri në pesë vjet burgim”.

263. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5.1 Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (Neni 108, paragrafët: 1, 2, 3, 4 dhe 5)

“Neni 108 (Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi)

(1) Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit ose personin juridik në të cilin është i punësuar apo organizatën tjetër të biznesit ose për personin juridik:

- 1) Krijon apo mban fonde të palejuara në Kosovë ose në çfarëdo juridiksioni tjetër;*
- 2) paraqet në mënyrë të rremë gjendjen, rrjedhën e parasë dhe rezultat e veprimtarisë afariste duke prezantuar dokumente me përmbajtje të pavërtetë, bilance të rreme, vlerësim të rreme ose gjatë inventarizimit, ose me prezantim tjetër të rremë apo fshehje të fakteve, me ç'rast i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e punës së bashkuar ose cilindo person tjetër juridik me rastin e vendimmarrjes së politikës qeverisëse.;*
- 3) Vendos organizatën e biznesit apo personin juridik në një pozitë më të favorshme duke siguruar fonde apo përfitime tjera të palejueshme me rregulloret në fuqi;*
- 4) Nuk i paguan mjetet nga detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera fiskale në Kosovë;*
- 5) Mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë”.*

264. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5.2 Tregtia e ndaluar (Neni 116)

“Neni 116 (Tregtia e ndaluar)

(1) Kushdo që pa autorizim siguron prodhime apo çfarëdo mallra tjera në sasi apo vlera të mëdha me qëllim të shitjes, apo që pa autorizim është i përfshirë në tregti në shkallë të gjerë apo në ndërmjetësimin në tregti apo në përfaqësimin e organizatave vendore të punës së bashkuar në këmbim të mallrave dhe shërbimeve, do të gjyket apo dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Kushdo që është i përfshirë në shitjen e mallrave prodhimin e të cilave ai e ka organizuar në mënyrë të paligjshme do të dënohet me të njëjtin dënim.

(3) Kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallit a të sendeve, qarkullimi i të cilave është i ndaluar apo i kufizuar, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(4) Nëse kryesi i veprës nga paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni ka organizuar rrjetin e stërshitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë 30.000 dinarëve dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(5) Malli dhe sendet e tregtisë së ndaluar konfiskohen”.

265. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5.3 Shmangia nga tatimi (Neni 123)

“Neni 123 (Shmangia nga tatimi)

(1) Kushdo i cili me qëllim që ai apo personi tjetër t’i shmanget pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave, sigurimit shoqëror apo kontributeve të tjera të përcaktuara me ligj jep të dhëna të pavërteta për të ardhurat e veta apo nuk i përfshin informatat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për përcaktimin e detyrimeve të këtilla apo kushdo që me qëllimin e njëjtë me rastin e raportimit të tatimeve të obligueshme nuk i raporton të ardhurat e fituara në mënyrë të ligjshme, ndonjë çështje ose fakte të tjera relevante për përcaktimin e detyrimeve të këtilla dhe nëse shuma e obligimit pagesa e të cilit shmanget është mbi 10,000 dinarë dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse shuma e shmangur e detyrimit nga paragrafi 1 i këtij neni, është më e lartë se 50.000 dinarë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në dhjetë vjet”.

266. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5.4 Shkatërrimi apo dëmtimi i pajisjeve të infrastrukturës komunale (Neni 158)

“Neni 158 (Shkatërrimi apo dëmtimi i pajisjeve të infrastrukturës komunale)

(1) Kushdo që shkatërron, dëmton, ndryshon, nxjerr nga përdorimi, apo heq pajisjet e infrastrukturës komunale, pajisjet e ujësjellësit, ngrohjes, gazit apo energjisë apo instalimet e sistemeve komunikuese, dhe rrjedhimisht shkakton shkatërrim të konsiderueshëm të jetës së qytetarëve, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet për shkak të pakujdesisë, kryesi do të dënohet me deri në tri vjet burgim”.

267. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e

gasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5.5 Rrezikimi i trafikut publik me vepra apo me mjete të rrezikshme (Neni 167)

“Neni 167 (Rrezikimi i trafikut publik përmes veprave apo mjeteve të rrezikshme)

(1) Kushdo që duke shkatërruar, hequr apo shkaktuar dëme të mëdha në instalimet, pajisjet, shenjat apo instalimet sinjalizuese të trafikut të cilat kanë për qëllim sigurinë në trafik ose që duke dhënë shenja apo sinjale jopërkatese, duke vendosur pengesa në qarkullimin e trafikut apo në çfarëdo mënyre tjetër rrezikon trafikun publik deri në atë shkallë sa të rrezikohet jeta apo trupi njerëzor apo pasuria e konsiderueshme do të dënohen me deri në tri vite burgim.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet për shkak të pakujdesisë, kryesi do të dënohet me deri në një vit burgim”.

268. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e gasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5.6 Falsifikimi i dokumenteve (Neni 203)

“Neni 203 (Falsifikimi i dokumenteve)

(1) Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal dënohet me burgim deri në tre vjet.

(2) Tentativa do të dënohet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, çekun, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistri tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet”.

269. Sa i përket kësaj vepre të amnistuar penale, Gjykata konsideron se është e vështirë të shihet se si mund të hyjë ajo brenda sferës së objektivave të Ligjit. Siç u përmend më lart, vepra e amnistuar penale duhet të ketë lidhje me objektivat e amnistisë, pra t'i japë fund konfliktit ose të promovojë pajtimin ndërmjet palëve të përfshira, duke qenë pjesë e marrëveshjes për paqe. Amnistimi i kryesve, siç është paraparë me këtë nen, nuk i plotëson këto kërkesa.

270. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet, ndër të tjera, në parimin e sundimit të ligjit, që nënkupton edhe aspektin e sigurisë juridike. Siguria juridike duhet të garantojë stabilitetin e një

sistemi juridik, që do të thotë se individët duhet të gëzojnë garancitë që ofron sistemi juridik në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

271. Gjykata konsideron se, në një sistem të sundimit të ligjit, personat fizikë dhe juridikë duhet të jenë në gjendje të mbështeten në dokumente publike, siç janë dokumentet për të drejtat pronësore, dhe të kontestojnë vërtetësinë e një dokumenti që do të kufizonte të drejtat e tyre. Ndryshe, parimi i sigurisë juridike do të minohej, pasi individët më nuk do të mund të ishin të sigurt se dokumentet e tilla nuk janë falsifikuar.
272. Kështu, viktimat e veprave të tilla penale do të pengoheshin të kenë qasje në drejtësi, sepse ata do të duhej të provonin në procedurë civile se dokumentet nuk janë të vërteta, ndërsa gjyqtari do të duhej të merrte parasysh se vepra penale është amnistuar.
273. Për më tepër, kryesit e veprave penale, të cilët bien në fushëveprimin e këtij neni, kanë për detyrë të paraqesin produktet e veprës penale. Nëse jo, kjo do të rrezikonte parimet e lartpërmendura dhe do të dëmtonte Kosovën si shtet i sundimit të ligjit.
274. Prandaj, Gjykata konkludon se kjo vepër e amnistuar penale nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me parimet e mishëruara aty.

1.3.5.7 Falsifikimi i dokumenteve zyrtare (Neni 184)

“Neni 184 (Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurisë)

(1) Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar ose personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare të sigurimit publik, apo të ruajtjes së rendit publik dënohet me burgim deri në tre vjet.

(2) Nëse vepra penale nga Paragrafi 1 i këtij Neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo të ndihmësit të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës kryesi dënohet me burgim prej pesë muajve deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të personit zyrtar ose të ndihmësit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(4) Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafët 1, 2 ose 3 të këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal i personit zyrtar ose i ndihmësit të tij, ai do të gjobitet apo të dënohet me burgim deri në gjashtë muaj, por edhe mund të lirohet nga dënimi”.

275. Gjykata vëren se, vepra e amnistuar nga pika 1.3.5.7 e Ligjit për Amnisti, i referohet nenit 184 (Falsifikimi i dokumentit zyrtar). Megjithatë, pas shikimit të nenit në Kodin Penal përkatës, Gjykata vëren se neni 184 i referohet “Sulmit

ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurisë". Referenca e saktë për falsifikimin e dokumentit zyrtar, prandaj, duhet të jetë neni 216.

276. Neni 216 i Kodit Penal në fjalë thotë:

"Neni 216 (Falsifikimi i dokumentit zyrtar)

(1) Një person zyrtar që jep të dhëna të pavërteta apo që nuk jep të dhëna të rëndësishme në një dokument zyrtar, regjistër apo dokument¹ ose me nënshkrimin e tij apo vulën zyrtare vërteton një dokument zyrtar, regjistër apo dokument me përmbajtje të pavërtetë, ose i cili me nënshkrimin e tij apo vulën zyrtare mundëson lëshimin e një dokumenti zyrtar, regjistri, apo dokumenti me përmbajtje të pavërtetë do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

(2) Një person zyrtar i cili, gjatë zbatimit të detyrës zyrtare, shfrytëzon një dokument, regjistër apo dokument zyrtar të falsifikuar si të vërtetë, apo që shkatërron, fsheh apo dëmton në shkallë të madhe apo në çfarëdo mënyre tjetër e bën të papërdorshëm një dokument zyrtar, regjistër apo dokument do të dënohen me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar apo ndonjë organizatë tjetër vetëqeverisëse apo shoqatë apo organ vetëqeverisëse, që kryen veprën nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, do të dënohet me dënimin e caktuar për këtë akt".

277. Gjykata supozon se referenca e saktë, në të cilën është menduar me Ligjin për Amnisti, është në të vërtetë neni 216 i Ligjit Penal të KSAK, i vitit 1977, sepse neni 184 përmendet në pikën 1.3.5.9.

278. Sa i përket falsifikimit të dokumentit zyrtar, Gjykata konsideron se arsyetimi i njëjtë, sikurse në veprën e lartpërmendur penale nga neni 203 i Ligjit Penal të KSAK, vlen edhe për këtë vepër të amnistuar penale.

279. Gjykata, rrjedhimisht, konkludon se kjo vepër e amnistuar penale nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe me parimet e mishëruara aty.

1.3.5.8 Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (Neni 183);

"Neni 183 (Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare)

(1) Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të atëçastshëm të dhunës, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushën e veprimit e kompetencave të tij ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin fyerjen ose keqpërdorimin e personit zyrtar apo kanosjen për përdorimin e armës

ose rezulton me lëndim të lehtë trupor, kryesi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik, ose të sigurisë së shtetit apo të ruajtjes së rendit publik, burgosjes së kryesit të veprës penale apo të ruajtjes së personit të privuar nga liria, kryesi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(4) Tentativa për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni dënohet.

(5) Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal i personit zyrtar, ai do të gjobitet apo të dënohet me burgim deri në gjashtë muaj, por edhe mund të lirohet nga dënimi”.

280. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.5.9 Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare (Neni 184, paragrafët: 1, 2 dhe 4), përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me dëmtime të rënda trupore ose me vdekje

“Neni 184 (Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurisë)

(1) Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar ose personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare të sigurimit publik, apo të sigurisë së shtetit apo të ruajtjes së rendit publik dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo të ndihmësit të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës kryesi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

...

(4) Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal i personit zyrtar ose i ndihmësit të tij, i njëjti dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj, por mund edhe të lirohet nga dënimi”.

281. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.3.6 Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale (Neni 200, përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje)

“Neni 200 (Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale)

(1) Kushdo që merr pjesë në një turmë të mbledhur, e cila me veprime kolektive e privon personin nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, dëmton pasurinë në përmasa të mëdha ose kryen vepra të tjera të shkeljeve të rënda apo tenton të kryejë vepra të tilla dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(2) Organizuesi i turmës që kryen veprën e cekur në paragrafin 1 të këtij neni dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet”.

282. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.4 Veprat penale të parapara me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 44, 8 tetor 1976

1.4.1 Rrezikimi i integritetit territorial (Neni 116)

“Neni 116 (Rrezikimi i integritetit territorial)

(1) Kushdo që kryen një vepër që synon shkëputjen e një pjese të territorit të RSFJ-së me forcë apo në çfarëdo mënyre tjetër jokushtetuese, apo bashkimit të një pjese të territorit me një shtet tjetër, do të dënohet me burgim prej jo më pak se pesë vjet.

(2) Kushdo që kryen një vepër që synon ndërrimin e kufijve në mes të republikave dhe krahinave autonome me forcë apo në çfarëdo mënyre tjetër jokushtetuese, do të dënohet me burgim prej jo më pak se një vit”.

283. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.4.2 Spiunazhi (Neni 129)

“Neni 129 (Zbulimi i sekretit shtetëror)

(1) Kushdo që pa autorizim ia zbulon, përcjell apo bën të qasshëm informacionin e dokumenteve që përbëjnë sekret shtetëror një personi të paautorizuar që nuk ka të drejtë të pranojë dokumente të tilla, do të dënohet me burgim prej jo më pak se një viti.

(2) Nëse vepra e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni është kryer gjatë gjendjes së luftës apo kërcënimit të menjëhershëm të luftës, ose nëse ka çuar në kërcënimin e sigurisë, ekonomisë apo fuqisë ushtarake të RSFJ-së, shkelësi do të dënohet me burgim prej jo më pak se tri vjet apo me burgim në kohëzgjatje prej 20 vjetësh.

(3) Nëse vepra e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni është kryer për shkak të moskujdesit, kryesi do të dënohet me burgim në kohëzgjatje që i tejkalon gjashtë muaj por që nuk i kalon pesë vjet.

(4) Termi sekret shtetëror do të kuptohet si informacion apo dokumente publikimi i të cilave shkakton ose mund të ketë shkaktuar pasoja përkeqësuese për interesat politike, ekonomike apo ushtarake të shtetit”.

284. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

1.4.3 Nxitja e urrejtjes, grindjes apo armiqësisë kombëtare, racore apo fetare (Neni 134)

“Neni 134 (Nxitja e urrejtjes, grindjes apo armiqësisë kombëtare, racore apo fetare)

(1) Kushdo që përmes mjeteve të propagandës apo në çfarëdo mënyre tjetër nxit apo admiron urrejtjen apo grindjen kombëtare, racore apo fetare në mes të kombeve dhe kombësive që jetojnë në RSFJ, do të dënohet me burgim në kohëzgjatje mbi një vit por që nuk tejkalon kohëzgjatjen prej dhjetë vjet.

(2) Kushdo që, duke fyer qytetarët në një mënyrë ose tjetrën, nxit armiqësi kombëtare, racore apo fetare, do të dënohet me burgim në kohëzgjatje që i tejkalon tre muaj por që nuk i tejkalon tri vjet.

(3) Nëse një vepër që është paraparë në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është kryer sistematikisht ose duke shfrytëzuar përparësinë e pozitës së dikujt apo funksionit, si pjesë e grupit, ose nëse trazirat, dhuna apo pasoja tjera të rënda kanë rezultuar nga këto akte, kryesi për një vepër të paraparë në paragrafin 1 do të dënohet me burgim prej jo më pak se një viti dhe për një vepër të paraparë në paragrafin 2 me burgim në kohëzgjatje që tejkalon gjashtë muaj por nuk i tejkalon pesë vjet”.

285. Gjykata konsideron se kjo vepër e amnistuar penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

IV. Neni 4 (Përjashtimet nga amnistia)

“1. Amnistia nga cilado vepër penale e përmendur në këtë ligj nuk do të aplikohet për:

1.1 Veprat kundër aktorëve ndërkombëtarë dhe forcave ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë. Anëtarët e forcave ndërkombëtare të sigurisë janë gjithmonë nën juridiksionin e shtetit dërgues;

1.2 Veprat të cilat përbëjnë shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare, përfshirë ato vepra penale të Kapitullit XV të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kapitullit XIV të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Kapitullit XVI të Kodit Penal të RSFJ, 1976.

1.3 Veprat penale që kanë rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje”.

286. Gjykata konsideron se ky nen i Ligjit për Amnisti është në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara të së drejtës ndërkombëtare përkitazi me ato vepra penale që kurrë nuk mund të amnistohen.

V. Neni 5 (Të drejtat e palëve të treta)

“Me dhënien e amnistisë nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në dënimin apo aktgjykimin”.

287. Sa i përket këtij neni, Gjykata merr parasysh se amnistia, sipas Ligjit për Amnisti, mund të jepet gjithashtu edhe për personat që janë duke vuajtur dënimin për kryerjen e një vepre penale të përfshirë në Ligjin për Amnisti, personat të cilët janë në ndjekje penale për vepra të tilla penale, ose personat që mund të jenë objekt i ndjekjes penale për vepra të tilla penale (Shih paragrafët: 141, 146-151).

VI. Neni 6 (Njoftimi për gjendjen e personave në mbajtjen e dënimit, të cilët i nënshtrohen amnistisë)

“1. Shërbimi Korrektues i Kosovës është i detyruar që në afat prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të njoftojë me shkrim gjykatën e cila ka gjykuar në shkallë të parë për personat e dënuar të cilët gjenden në mbajtjen e dënimit dhe që përfshihen me ligjin e amnistisë.

2. Njoftimi duhet të përmbajë, përveç informatave të tjera, informatat për datën e fillimit të ekzekutimit dhe të skadimit të dënimit.

3. Gjykata, sipas detyrës zyrtare, nxjerr vendim për zbatimin e amnistisë në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, ndërsa për personin e dënuar, i cili nuk ka filluar mbajtjen e dënimit, vendimin për zbatimin e amnistisë gjykata duhet ta nxjerr në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

4. Nëse i dënuari mban dënimin në shtetin tjetër, njoftimi duhet të bëhet përmes Ministrisë së Drejtësisë”.

288. Gjykata konsideron se kjo dispozitë procedurale përkitazi me amnistimin e një vepre penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

VII. Neni 7 (Vendosja për zbatimin e amnistisë nga ekzekutimi i dënimit)

“1. Për zbatimin e amnistisë vendos gjykata e cila ka vendosur në shkallën e parë, me ndihmën e EULEX-it, përkatësisht gjykata që ka kompetencë lëndore dhe territoriale që të gjykojë çështjen e caktuar që i është adresuar asaj:

1.1 sipas detyrës zyrtare; apo

1.2 sipas kërkesës së personit të dënuar, kryesit të veprës penale, Prokurorit të Shtetit apo personave të cilët, sipas Kodit për Procedurën Penale, mund të ushtrojnë ankesë kundër vendimit gjyqësor.

2. Gjykata vendos me vendim me të cilin përcakton pjesën e dënimit nga ekzekutimi i së cilës i dënuari është liruar, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe”.

289. Gjykata konsideron se kjo dispozitë procedurale përkitazi me amnistimin e një vepre penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

VIII. Neni 8 (Vendosja për zbatimin e amnistisë nga ndjekja penale)

“1. Në rastet kur është bërë kallëzim penal, është nisur një hetim, apo është ngritur aktakuzë, prokurori kompetent merr vendim për të dhënë amnisti nga ndjekja penale, në përputhje me këtë ligj.

2. Brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, prokurori kompetent do të marrë vendim sipas detyrës zyrtare në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, për të hedhur poshtë kallëzimet penale ose të pushojë hetimet për veprat penale të përcaktuara në këtë ligj.

3. Brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dënimet e formës së prerë që bien në fushëveprimin e nenit 3 të këtij ligji do të fshihen nga evidenca penale në përputhje me ligjet relevante të aplikueshme”.

290. Gjykata konsideron se kjo dispozitë procedurale përkitazi me amnistimin e një vepre penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar

detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

IX. Neni 9 (Plotfuqishmëria e konfiskimit)

“Pavarësisht aplikueshmërisë së amnistisë ndaj çfarëdo vepre penale sipas këtij ligji, nëse një send është konfiskuar në përputhje me ligjin gjatë procedurës penale bazuar plotësisht apo pjesërisht në atë vepër penale, personi i cili përfiton nga amnistia nuk ka të drejtë që ta kërkojë kthimin e sendit të konfiskuar”.

291. Gjykata konsideron se kjo dispozitë procedurale përkitazi me amnistinë e një vepre penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

X. Neni 10 (Ankesa ndaj vendimeve për dhënien e amnistisë)

“1. Kundër vendimeve për amnisti, mund të paraqitet ankesë Gjykatës së Apelit në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Gjykata e Apelit nxjerr vendim sipas ankesës në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të shkresave.

2. Ankesa e ndalon ekzekutimin e vendimit.

3. Nëse për shkak të zbatimit të amnistisë i dënuari do të lirohet nga mbajtja e dënimit me burg, gjykata me vendimin e njëjtë do të vendosë edhe për lirimin, i cili vendim pa shtyrje i dërgohet Shërbimit Korrektues të Kosovës”.

292. Gjykata konsideron se kjo dispozitë procedurale përkitazi me amnistinë e një vepre penale është e një natyre që nuk cenon të drejtat themelore të palëve të dëmtuara dhe nuk privon të drejtën e qasjes në gjykatë për të përcaktuar detyrimet civile. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundim se kjo dispozitë është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

XI. Neni 11 (Zbatimi subsidiar)

“Për zbatimin e amnistisë përshtatshëmrisht aplikohen dispozitat e Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, në qoftë se me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe”.

XII. Neni 12 (Hyrja në fuqi)

“Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.

Sa i përket procedurës për miratimin e ligjit të kontestuar

293. Parashtruesit ankohen se procedura për miratimin e ligjit të kontestuar shkel:

- a. Nenin 65, paragrafi 4, të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse “*[...] mbledhja është thirrur pa u përmbushur kushtet e parapara në këtë dispozitë dhe rendi i ditës është futur në kundërshtim me afatet kohore të parapara me këtë dispozitë*”; dhe
 - b. Nenin 57, paragrafi 3, të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse “*[...] iu është cenuar deputetëve e drejta për dërgimin e amendamenteve në afatin kohor të paraparë me Rregullore*”.
294. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se, më 28 maj 2013, Qeveria, në pajtim me kompetencat e saj sipas nenit 92.4 të Kushtetutës, i propozoi Kuvendit Projektligjin për Amnisti.
295. Përkitazi me këtë, sipas amendamentit të nenit 65.15 të Kushtetutës (shpallur në Gazetën Zyrtare më 26 mars 2013) Kuvendi “*do të shpallë amnisti me ligjin përkatës, i cili do të miratohet nga dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve në Kuvend*”.
296. Në rastin konkret, Kuvendi votoi dhe miratoi Ligjin për Amnisti me 90 vota për, me 17 vota kundër dhe me 1 abstenim.
297. Sa i përket pohimeve të parashtruesve se është shkelur Rregullorja e punës së Kuvendit, Gjykata i referohet rastit të saj, Rasti KO29/11, ku vendosi se “*[...] detyra e saj është që të vlerësojë vetëm shkeljet e pretenduara të Kushtetutës*” (Shih Rastin KO29/11, parashtrues Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë, Aktgjykimi i 30 marsit 2011). Vlerësimi i Ligjit për Amnisti përkitazi me pajtueshmërinë e tij me Rregulloren e punës së Kuvendit është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë dhe, rrjedhimisht, bie jashtë juridiksionit të Gjykatës.
298. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se procedura për miratimin e ligjit të kontestuar është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 65.15 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, rrjedhimisht, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 36 të Rregullores së punës, më 3 shtator 2013,

VENDOSI

- I. NJËZËRI, TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. NJËZËRI, TË SHPALLË që, procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit për Amnisti, Nr. 04/L-209, është në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

III. ME SHUMICË VOTASH, TË SHPALLË që Ligji për Amnisti, Nr. 04/L-209, për sa i përket përmbajtjes, është në pajtueshmëri me Kushtetutën, me përjashtim të këtyre neneve, të cilat shpallen të pavlefshme: 1.1.10 (Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë), 1.1.11 (Zjarrvënia), 1.1.15.10 (Falsifikimi i dokumenteve), 1.1.15.11 (Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve), 1.2.5 (Dëmtimi i pasurisë së luajtshme), 1.2.9.7 (Falsifikimi i dokumenteve zyrtare), 1.3.1 (Dëmtimi i sendit të huaj), 1.3.5.6 (Falsifikimi i dokumentit) dhe 1.3.5.7 (Falsifikimi i dokumentit zyrtar);

përkitazi me veprat vijuese penale:

- nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 19/13 2012), nenet: 333 (1), 334 (1), 398 dhe 399 (1) 1.1, 1.4;
- nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25, e 6 korrikut 2003; Gazeta Zyrtare nr. 2003/25, dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/19 për ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës), nenet: 260 dhe 348;
- nga Ligji Penal i KSAK (Gazeta Zyrtare nr. 20/77 dhe Rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe nr. 2000/59 përkitazi me ligjin e aplikueshëm në Kosovë), nenet: 145, 203 dhe 216.

IV. TË SHPALLË se, në pajtim me nenin 43 të Ligjit, Ligji për Amnisti, Nr. 04/L-209, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje, në pajtim me modalitetet e përcaktuara në këtë aktgjykim;

V. T'UA KOMUNIKOJË këtë aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

VI. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit;

VII. TË SHPALLË që ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani